



PROF.DR.HFZ.
HAJREDIN HOXHA

REFLEKSIONE
EDUKATIVE,
ARSIMORE, RELIGJIOZE
BASHKËKOHORE



Prof.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

REFLEKSIONE

EDUKATVE, ARSIMORE, RELIGIOZE BASHKEKOHORE

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Recesent: Ajni Sinani

Redaktura & Korektura: Mimoza Sinani

Dr. Hajredin HOXHA

REFLEKSIONE

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij librit në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të autorit.

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:
Sedat ISLAMI

Titulli në origjinal:

Dr. Hajruddin Huxheh,

Ishrakatun fikrijjetun terbevijjetun muasaretun,
editimi i parë, 2009. Metabiu'rr Rreshid.

Dr. Hajredin HOXHA

REFLEKSIONE

Përmbajtja

Globalizmi – shembulli më i freskët i skllavërimit të njerëzimit, prandaj duhet refuzuar

Fetvatë i nënshtrohen tipareve dalluese: ajo çka vlen për Lindjen mund të mos vlejë për Perëndimin

Islami dhe roli i tij në ruajtjen e civilizimit perëndimor nga shpërbërja

Drejt një metodologjie dinamike dhe aplikative në komentimin e Kur'anit fisnik

Terrorizmi, sfondi i tij historik dhe lëçitja e Islamit prej tij

Islami ndërmjet aprovimit të mesatares dhe refuzimit të terrorizmit me të gjitha format e tij

Radikalizmi dhe ekstremizmi i të rinjve për shkak të mungesës së dijes dhe njohurive

Mësime dhe urtësi nga strategjia e bashkëveprimit me të tjerët

Malajzia si model për arsimimin e dëshiruar në kohën bashkëkohore

Drejt një metodologjie kur'anore mbi kritikën

Si t'i rezistojmë kulturës globale?

Parametrat edukativë në mendimet e Imam Neveviut [*Allahu e mëshiroftë*] 1-3

Mësimi i devotshmërisë i përfituar nga agjërimi i ramazanit

Ajo që fshehin në zemrat e tyre është edhe më e madhe

Drejt projektit të islamizimit të shkencave shoqërore – vështrim kulturor

Hyrje

Falënderimet i takojnë Allahut, ndërsa përshëndetjet qofshin për zotërinë e njerëzimit, Muhammedin, familjen dhe shokët e tij!

Të dashur lexues!

Ky libër, në esencë, ngërthen një përmbledhje artikujsh dhe intervistash me tematika të ndryshme islame, kulturore dhe ideore, të zhvilluara dhe publikuara në disa gazeta dhe revista në Kuvajt, El Bahrejn dhe në Arabinë Saudite. Në to kam rrahur një mori çështjesh bashkëkohore dhe ato që merren si *'tema të nxehta'* për kohën tonë, si: dialogu, globalizmi, terrorizmi, mesatarja, roli i Islamit në civilizimin botëror etj. Në këto punime është diskutuar edhe për vuajtjet e muslimanëve shqiptarë dhe boshnjakë në Shqipëri, Kosovë dhe Bosnjë gjatë kohës së luminizmit dhe kohës sonë moderne.

Nuk kam as më të voglin dyshim se tema si këto kërkojnë trajtim edhe më serioz, por besoj se ato mund të konsiderohen si teza dhe teori të reja të ofruara nga një hulumtues që sfidat dhe problemet i ka përjetuar nga afër.

E lus Allahun që këtë libër të ma vendosë në peshoren e veprave të mira!
Po ashtu e lus Atë që ky libër të jetë i pëlqyer prej jush, lexues të nderuar!

Gazeta e pavarur bahrejiane, ditore dhe politike, *el-Vakt*

Nr. 718, e xhuma, Safer 1429 / 08.02.2008

Refleksione

Intervista e studiuesit kosovar Dr. Hajredin Hoxha në gazetën el-Vakt

GLOBALIZMI - SHEMBULLI MË I FRESKËT I SKLLAVËRIMIT TË NJERËZIMIT, PRANDAJ DUHET REFUZUAR (1)

El-Vakt: Nadir Metruk:

Dr. Hajrudin Hoxha, profesor i studimeve islame në Universitetin Tajjiba në Arabinë Saudite, pajtohet me ne përkitazi me faktin se globalizmi mëton të krijojë një shoqëri injorante, e cila qarkullon si një qenie e gjallë dhe që i shtyn organet – gjymtyrët e saj që ta mbrojnë atë dhe ekzistimin e saj. Bazuar në këtë, Dr. Hoxha mendon se Islami do të mund t’i rezistojë atij vetëm në formën e një shoqërie të shquar për karakteristika dhe veçori, por gjithsesi më të theksuara, të forta dhe të qëndrueshme. Përderisa përshkruan disa gjëra që e bëjnë atë ta refuzojë absolutisht globalizmin, ai sjell Islamin si alternativë, duke nënvizuar se *‘Islami i ndryshon sjelljet e individit që beson në të sikurse që ndryshon sjelljet e shoqërive që tregohen të sigjerta në praktikimin e rregullave të tij.’* Ndërsa përkitazi me kërcënimet e globalizmit për identitetin e muslimanëve, Dr. Hoxha mendon se *‘përforcimi para sfidave të globalizmit dhe çfarëdo kulture tjetër devijante do të mund të bëhet vetëm atëherë kur institucionet tona do të veprojnë si organ i vetëm,*

ndryshe nuk mund të jetësohen ndryshime pozitive kur një thërret në të mirë ndërsa dhjetë në të keqe.'

El-Vakt: Nadir Metruk: Bota islame përballlet sot me rreziqe shumë serioze, të cilat e kërcënojnë atë edhe në nivel të identitetit kulturor dhe civilizues. Globalizmi kërcënon esencën e vetëdijes fetare dhe botëkuptimet e modelit të saj për jetën. Por, fillimisht, si do të mund të na e përshkruanit shkurtimisht gjendjen e muslimanëve në botën islame?

Dr. Hajredin Hoxha:

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!

Sigurisht se muslimanët dhe e tërë bota islame janë duke kaluar në një ndër etapat më të errëta të tyre. Vështirësitë me të cilat përballen janë shumë të mëdha dhe vërtet ata janë lodhur e dobësuar aq shumë sa edhe një gjeni do ta kishte të vështirë ta përshkruante gjendjen në të cilën janë. Ata janë larguar nga parimet dhe vlerat islame, janë ndarë e përçarë, kanë ngelur prapa në zhvillim dhe përparim, papunësia dhe varfëria kanë shënuar nivelet më të larta të mundshme, kredibiliteti i shteteve dhe institucioneve dhe shoqatave islame ka rënë shumë, ndërsa pushtimi i tokave të tyre dhe plaçkitja e të mirave të tyre është bërë një punë që edhe i ligu e bën pa frikë fare. Po ashtu, feja dhe libri i shenjtë i tyre, Kur'ani, janë bërë objekt fyerjesh e ofendimesh nga jobesimtarët dhe të pafetë në mediat dhe mjetet e tyre të informimit. Këto dukuri, në këtë kohë të globalizmit apo injorancës¹ aktuale, janë bërë si të thuash emërtim apo sinonim i muslimanëve dhe botës islame.

El-Vakt: Nadir Metruk: **A mund të themi se globalizmi është sfidë e njëmendtë në këtë drejtim, apo është 'inJORANCË' siç e quani ju?**

Dr. Hajredin Hoxha: Allahu i Madhëruar në Kur'anin Famëlartë ka thënë:

¹ Me këtë nënkuptohet degjenerimi dhe sjelljet devijante, që janë rezultat i kulturës moderne, e cila është larg mësimave fetare dhe respektimit të tyre. Ky term përsëritet disa herë, andaj duhet të kuptohet me këtë domethënie.

Ata duan ta shuajnë dritën e All-llahut me gojët e tyre, po All-llahu e plotëson (e përhap) dritën e Vet, edhe pse e urrejnë jobesimtarët.” (es-Saff: 8)

Gjithqysh ti do të vëresh se jehuditë dhe ata që i përshkruan Zotit shok (idhujtarët) janë njerëzit me armiqësi të fortë kundër besimtarëve (kundër muslimanëve). Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë: "Ne jemi nesara-krishterë". Këtë ngase prej tyre (të krishterëve) ka dijetarë (ulema) dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneçë.” (el-Maide: 82)

Ata që e mohuan të vërtetën (Jobesitaret) janë miq të njëri-tjetrit. E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoni e të kujdeseni për njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmujë e madhe në tokë.” (el-Enfalë: 73)

Imam Ahmedi transmeton në Musnedin e tij nga Theubani se Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] ka thënë:

- Gati është që t'iu vërsulen juve popujt nga çdo anë, ashtu siç ngrënësit i vërsulen pjatës. - O i Dërguari i Allahut! A për shkak se ne do të jemi pak?- i thamë. - Jo, atëbotë ju do të jeni shumë, vetëm se do të jeni si shkuma e detit (e pavlerë); armiqve do t'iu nxirret nga zemra frika prej jush, ndërsa në zemrat tuaja do të hidhet vehni - tha. E ç'është vehni? - e pyetën. Dashuria për dynjanë dhe urrejtja e vdekjes - tha ai.”

Dijetarët dhe komentuesit për ajetet që cituam më parë, e në veçanti për ajetin nga kaptina el-Enfalë, kanë dhënë shpjegime të mrekullueshme. Mendoj se ia vlen që të shkëpusim diç nga këto komente, për të ndërtuar një qëndrim konstruktiv përballë globalizmit apo injorancës bashkëkohore, e rrjedhimisht edhe për të sqaruar rrugët e sigurta të ruajtjes së identitetit tonë islam. Dijetarët kanë thënë: metodologjia dinamike e kësaj feje, që i reziston aktualitetit gjithnjë me mjete ekuivalente, është metodologji dinamike dhe elastike por e qëndrueshme dhe e qartë. Ata që kërkojnë mënyra dhe forma të rezistimit ndaj aktualitetit nuk do të kenë nevojë të shpikin komentime apo shpjegime të paqena. Ajo që duhet dhe kërkohet prej tyre është devotshmëria dhe shmangia nga përpjekja për t'ia

nënshtuar fenë aktualitetit injorant dhe të damkosur. Për shkak se injoranca nuk përkufizohet vetëm në teori por edhe në formacion dinamik, atëherë tentativa e zhdukjes së saj dhe rikthimit të njerëzve sërish në fenë e Zotit, nuk guxon dhe nuk ia vlen që të reduktohet vetëm në teori. Kështu, rezistenca jo vetëm që nuk do të ishte superiore ndaj sfidës, që thamë se nuk reduktohet në teori por në formacion shumë aktiv, por as që do të ishte ekuivalente me të. Gjithsesi, këto përpjekje duhet të transformohen në formacione të gjalla dhe aktive që, në krahasim me formacionin injorant, janë më funksionale, më të organizuara dhe me të disiplinuar. Ndryshe, shoqëria islame nuk mund të paramendohet pa këto botëkuptime. Apo nuk arrihet që këto botëkuptime të përçohen tek njerëzit, sado shumë që mund të jenë ata numerikisht, përderisa ato nuk shndërrohen në një formacion aktiv, të shquar për koordinim dhe bashkëpunim të ndërsjellë, në një formacion të pavarur nga të tjerët, që vepron në drejtim të forcimit të ekzistencës dhe shtrirjes e zgjerimit të tij, sikurse që punon edhe për ta mbrojtur veten nga sfidat dhe rreziqet e jashtme. Ekzistimi, si teori, nuk do të ketë asnjë efekt, ndërsa rikthimi i Islamit si faktor që bën politikën e botës nuk ka mundësi të bëhet ndryshe. Nuk ka mundësi as të vazhdojë së ekzistuari nëse kriteret e theksuara më parë nuk përfillen, pra nëse nuk bashkëpunohet ndërmjet vete, ngase, ashtu sikurse që të pafetë janë miq ndërmjet vete, po kështu edhe ne duhet të jemi miq ndërmjet vete.

El-Vakt: Nadir Metruk: Pajtimi juaj me këtë përshkrim të globalizmit kërkon edhe më shumë shpjegime nga aspekti ideologjik dhe rrënjësor i globalizmit. Cila është domethënia filozofike dhe baza historike e globalizmit sipas jush?

Dr. Hajredin Hoxha: Realisht e shoh të arsyeshme të ndalemi në sqarimin e këtij termi, gjë të cilën e kanë bërë shumë mendimtarë e intelektualë, por të cilët në të vërtetë nuk e kuptojnë thellësisht atë. Globalizmi, sipas disa studiuesve, është term i ri në fjalorin ekonomik dhe politik. Ai (në arabisht: *el-avlemetu*) ka kuptimin e botës (*el-alem*) e jo të dijes (*el-ilm*). Ky definicion ka nevojë për sqarime, gjë që do ta bëjmë pak më vonë. Mu për këtë,

globalizmi përshkruhet si rend i ri, i cili synon organizimin e botës sipas një rregulli të ri dhe të vetëm, duke përfshirë politikën, ekonominë, kulturën, shoqërinë dhe edukimin. Thënë të drejtën, kjo nuk lë pa prekur edhe fenë.

Globalizmi është përtej kufijve gjeografikë dhe politikë të shteteve, ndërsa botën synon të shndërrojë në një fshat global të premtuar. Ndoshta mëton të jetë një perandori e re, me sfond dhe emër të ri.

Globalizmi ngrihet mbi këto baza: mendje elektronike dhe revolucion dijesh, të ngritura mbi njohuritë dhe shpikjet e pafundme teknologjike, pa përfillur fare vlerat, kulturën, organet, kufijtë gjeografikë dhe politikë etj. Globalizmi është një formë e re e betejës kulturore, të cilën perëndimi e ndërmerret kundër identiteteve të popujve, kulturave dhe civilizimeve të tyre, në radhë të parë kundër muslimanëve. Globalizmi bie ndesh plotësisht me Islamin, sikurse që bie ndesh me ligjet ndërkombëtare, me ekonomitë dhe qeverisjet kombëtare, me ligjin për pluralizëm fetar, kulturor dhe ideor. Kjo kulturë perëndimore-amerikane, me këtë ritëm, paraqet një kërcënim serioz për sigurinë e botës islame, por edhe për mbarë botën. Mendoj se vërtetimi i kësaj që po them nuk kërkon mund të madh. Mjafton t'i hedhësh një vështrim të përgjithshëm situatës në botë dhe të bindesh për këtë.

El-Vakt: Nadir Metruk: Disa studiues parapëlqejnë të bëjnë dallim ndërmjet universalizmit dhe globalizmit, po ju?

Dr. Hajredin Hoxha: Vërtet, është një detaj jo pak i rëndësishëm, për arsye se ka dallim ndërmjet asaj që është universale dhe asaj që është globale. Universalizmi reflekton ambicien për zhvillim dhe përparim individual (të shteteve) në nivel dhe rang botëror, ndërsa globalizmi nënkupton shkatërrimin e tërë asaj që është individuale në kontekstin e shteteve. Universalizmi nënkupton të qenit i hapur karshi tjetrit dhe shkëmbim të ndërsjellë ndërmjet vete, ndërsa globalizmi nënkupton shkatërrimin e asaj me të cilën veçohet tjetri dhe zhveshjen e tij prej saj. Përderisa nuk ka diç që

bie ndesh me Kur'anin dhe Sunnetin, universalizmi është i pranuar në Islam, madje përputhet me një veçori shumë të spikatur të tij, që është pikërisht universalizmi, i cili nuk përjashton asnjë njeri apo popull, por përfshin tërë jetën dhe problemet e saj. Ndërsa globalizmi, me domethëniet dhe botëkuptimet e tij, bie ndesh me Islamin, i cili dallimin dhe shumëllojshmërinë në gjuhë, ngjyrë, racë e sheh si shenjë të ekzistimit të Allahut. Allahu e krijoi njerëzimin prej një burri dhe gruaje dhe i ndau ata në popuj dhe fise që ta njohin njëri-tjetrin dhe të bashkohen që të gjithë nën flamurin e monoteizmit 'La ilahe il-la Allahu Muhammedun Resulullah!'

El-Vakt: Nadir Metruk: **Duke i parë nga ky këndvështrim aspektet kulturore negative të globalizmit, atëherë cilat janë qëllimet e tij. Ç'mund të na thoni për këtë?**

Dr. Hajredin Hoxha: Kultura globale ka disa qëllime, të cilat janë në shtim e sipër, siç vërejnë analistët. Ndër më të rëndësishmet prej tyre do të veçonim:

- 1) Mbizotërimi i Amerikës dhe Evropës në ekonominë botërore si dhe kontrollimi i stabilitetit politik dhe industrial për interesat e tyre,
- 2) Shkatërrimi i rrjetit kulturor dhe shoqëror të popujve,
- 3) Zhbërja e identiteteve fetare, kombëtare, kulturore dhe ideologjike të popujve,
- 4) Pasurimi i vendeve të pasura dhe varfërimi i vendeve të varfra,
- 5) Shpërbërja e disa shteteve, kulturave, civilizimeve dhe institucioneve e shoqatave kulturore dhe fetare,
- 6) Mbizotërimi politik, ekonomik, kulturor dhe ushtarak për të shfrytëzuar shtetet dhe të mirat e tyre materiale etj.

Amerika dhe Unioni Evropian i kanë nuhatur tashmë aspiratat e muslimanëve për krijimin e një strukture shtetërore të përbashkët mbi themelet e Islamit, strukturë kjo që do të garantonte të drejtat, nderin dhe pasuritë e tyre. Sigurisht se ata nuk do të rrinë duarkryq. Përkundrazi, do të përpiqen t'i japin fund Islamit me çdo formë apo mundësi që do t'iu

jepet. Madje ata kanë përgatitur formacione dhe fushata për ta sulmuar Islamin nëpërmjet këtyre metodave:

- 1) Pesha dhe ndikimi i tyre në botën islame.
- 2) Udhëheqja e shteteve kapitaliste, të cilat janë të prira për pjesëmarrje në fushatën kundër Islamit.
- 3) Legjitimiteti ndërkombëtar në kuptimin e organizatave, si Kombet e Bashkuara dhe kartat e tyre, si dhe shoqatat dhe organizatat që janë pjesë e saj ose nën administrim të saj.
- 4) Qendrat e pushtetit dhe vendimmarrjes në shtete të ndryshme, si dhe servilët e tyre nga radhët e hipokritëve dhe materialistëve.

Kjo fushatë amerikano-evropiane bazohet në katër moto apo parulla:

- 1) Demokracia, e cila nënkupton që populli të qeveriset me ligjet e njerëzve, pra jo me ligjin e Zotit
- 2) Pluralizmi politik dhe partiak
- 3) Të drejtat e njeriut, me të cilat synohet vetëm njeriu perëndimor
- 4) Politikatat e ndikimit apo dominimit mbi tregun global.

El-Vakt: Nadir Metruk: Kundruall këtij refuzimi që i bëni globalizmit me botëkuptimet që ofruat, çfarë ofroni si alternativë?

Dr. Hajredin Hoxha: Shkurt, alternativa është Islami, i cili në fakt është dhe opsioni i vetëm dhe pranimi i të cilit duhet bërë pa asnjë mëdyshje. Besimtarit, siç e dini, i ndalohet ta japë të mirën për një të keqe, dhe Islami, përderisa është besim dhe sistem jete, patjetër se na ofron zgjidhje dhe trajtime hyjnore për çdo problem. Allahu i madhëruar ka thënë:

“E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit.” (Ali Imran: 85)

Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni.” (el-En'amë: 153)

Bazuar në këtë, globalizmi, me këto botëkuptime, duhet refuzuar apriori. Ai s'është veçse një formë bashkëkohore e skllavërimit dhe robërimit të njerëzve.

El-Vakt: Nadir Metruk: Pas kësaj, cilat mendoni se janë rrugët më të sigurtat për mbrojtjen e identitetit islam përballë këtyre zhvillimeve të hovshme të kulturave globale?

*Dr. Hajredin Hoxha: Asgjë përveç Islamit nuk mund ta shpëtojë ummetin tonë përballë kësaj furtune që ka mbërthyer të gjitha poret e jetës. Armiqtë duan ta shtrembërojnë këtë fe, ta zhveshin atë nga parimet bazë dhe ta bëjnë të huaj për vetveten. Rinia jonë islame është njollosur me ideologjinë shterpe të Perëndimit, andaj ka nevojë për një zgjidhje. Për ta nuk mund të ketë rrugëdalje tjetër përveç Islamit. Patjetër duhet të luftohet injoranca në lidhje me fenë, si edhe boshllëqet shpirtërore, ideore dhe kulturore të muslimanët, veçanërisht tek rinia. Gjithsesi duhet ta luftojmë islamofobinë, që po ndjell zi ndaj parimeve dhe vlerave islame. Duhet të ringjallim traditën e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], tiparet dhe virtytet e tij, në mënyrë që njerëzve t'ua bëjmë të dashur fenë. Përvetësimi total i ideve, botëkuptimeve, filozofisë dhe kulturës perëndimore është i gabuar. Metodologjia jonë duhet të jetë selektive: të marrim atë që përputhet me fenë tonë, ndërsa t'i braktisim gjithë të tjerat që nuk përputhen. Çdo gjë duhet ta matim në peshoren e Kur'anit dhe Sunnetit, kështu çka përputhet, merret, e çka bie në kundërshtim, refuzohet.*

El-Vakt: Nadir Metruk: Si mund t'i përshkruani kriteret apo kufijtë e këtyre raporteve marrje-refuzim me kulturën perëndimore?

Dr. Hajredin Hoxha: Gjithsesi shoqërinë islame duhet ta ruajmë nga sëmundjet shpirtërore dhe psikike që janë në Perëndim, si p.sh. stresi, ankthi, depresioni, dëshpërimi, egoizmi, individualizmi etj. dhe këtë nëpërmjet seminareve, takimeve, ligjëratave, kampingjeve, vizitave etj. Duhet t'i shmangemi stilit dhe metodës të jetesës perëndimore. Prej saj duhet të marrim vetëm atë që është pozitive. Kjo për arsye se 'urtësia është

gjë e humbur e besimtarit dhe ai duhet ta marrë atë kudo që ta gjejë. Mëdyshjet dhe dilemat që mbjellin mosbesimtarët duhen zhvleftësuar me argumente racionale. Rrjedhimisht, të gjithë njerëzit duhet t'i thërrasim që t'i braktisin antivlerat dhe të pajisen me vlera. Çdo musliman duhet të vetëdijesohet karshi obligimit që ka për këshillimin e njerëzve. Po kështu, bijtë tanë duhet t'i vetëdijesojmë edhe karshi kësaj beteje ideologjike që është duke u zhvilluar, duke i pajisur me njohuri për të vërtetat islame, në mënyrë që të jenë të pathyer dhe të pamposhtur para çdo sfide.

El-Vakt: Nadir Metruk: Por çfarë kërkohet për të realizuar këtë në nivel individual? Cila është përgjegjësia e muslimanit si individ?

Dr. Hajredin Hoxha: E para, që mendoj se duhet bërë, është mos zhveshja nga e kaluara jonë e lavdishme, mos largimi nga rruga e dijetarëve tanë të sinqertë, mos zhveshja nga identiteti ynë, si dhe ruajtja e asaj me të cilën Allahu na veçoi dhe na dalloi nga të tjerët. Pastaj, duhet të përpiqemi që ta paraqesim imazhin islam ashtu siç është në të vërtetë, duhet ta propagandojmë të vërtetën e tij me të gjitha mjetet e ligjshme që kemi në dispozicion, sikurse që duhet të përpiqemi që ta njohim metodologjinë islame, përkitazi ndryshimin pozitiv kulturor, pra nga e keqja në të mirë, nga e mira në më të mirë, e kështu drejt më të përsosurës. Kjo arrihet duke e prezantuar kredon (akiden) islame ashtu si duhet dhe duke e zhveshur atë nga diskutimet e pafrytshme. Duhet të sqarojmë çështjet që lidhen me të, kapitujt e saj, si dhe të sqarojmë faktin se ajo i drejtohet tërë qenies së njeriut. Pra, akiden islame nuk duhet ta kufizojmë në të dhëna apo shpjegime teorike, në subjekte ose tema filozofike, apo në perceptime ideore. Përkundrazi, atë duhet ta ofrojmë si një të vërtetë jetësore, të cilën besimtari e jeton në praktikë çdo ditë, ngase tek ai që e ka të qartë kredon e tij dhe është i ndikuar prej saj, nuk ka se si të mos reflektohen ndryshimet pozitive në çdo pore të jetës së tij.

Gazeta e pavarur bahraniane, ditore dhe politike, *el-Vakt*

Nr. 739, e xhuma, 21 Safer 1429 / 29.02.2008

Refleksione

Intervista e studiuesit kosovar Dr. Hajredin Hoxha në gazetën el-Vakt

FETVATË I NËNSHTROHEN TIPAREVE KARAKTERIZUESE : AJO ÇKA VLEN PËR LINDJEN MUND TË MOS VLEJË PËR PERËNDIMIN (2)

El-Vakt: Nadir Metruk

Dr. Hoxha mendon se muslimanët në Gadishullin Ballkanik kanë hequr të zitë e ullirit nga sistemi komunist. Ai i fajëson komunistët se ishin pikërisht ata që ngjallnin ndjenjat e urrejtjes dhe ndiznin fitilat e saj kundër shtetit otoman në vendet që më parë kishin qenë nën sundimin e tyre, sidomos tek shqiptarët dhe boshnjakët. Po ashtu ai e akuzon komunizmin se ishte pengesa kyçe në vendosjen e marrëdhënieve ndërmjet feve. Ai shkoqit detaje nga kushtet dhe rrethanat jetësore të muslimanëve në Perëndim, ndërkohë që nuk harron t'i këshillojë ata që janë në këto vende që të jetojnë në përputhje me parimet që janë *'thabit'* të pandryshueshme, fikse dhe të konfirmuara, dhe atyre që ndryshojnë (apo *'et-tegajjur'* në arabishte.) Specifikimi i këtij rregulli – siç thotë ai – nuk paraqet ndonjë problematikë në Islam 'dhe kjo nuk është realizuar në saje të ndonjë revolucioni, beteje apo konflikti... por është bërë me aprovimin legjislativ hyjnor në Kur'an

dhe Sunnet. 'Thabit' (e qëndrueshme, statike) në Islam nuk nënkupton absoluten, por nënkupton të vërtetat dhe rregullat e veçanta. Po kështu edhe 'et-tegajjur', apo e ndryshueshmja, nuk është absolute dhe gjithëpërfshirëse, por nënkupton disa gjëra sekondare, të cilat doemos duhen ndryshuar².

El-Vakt: Nadir Metruk: Flitet për një përparim të hovshëm të gjallërimit islam në Perëndim. Disa shohin se Islami po faktorizohet gjithnjë e më tepër, ndërsa disa të tjerë, jomuslimanë, e shohin këtë të vërtetë si një shenjë ogurzezë, andaj tërheqin vërejtjen për të. A mund të na jepni një përshkrim të shkurtër dhe përmbledhës për gjendjen e muslimanëve në Evropën perëndimore dhe lindore?

Dr. Hajredin Hoxha: Prania e Islamit në Evropë kthehet pas deri në shekujt e hershëm, respektivisht, në shek. VIII-të, ose në vitin 711, kur muslimanët e çliruan Spanjën dhe u vendosën në të përafërsisht tetë shekuj. Me rënien e shtetit islam në Spanjë, u krijua shteti islam otoman, i cili dalëngadalë kishte filluar ta zgjeronte pushtetin në Ballkan, në Evropën Lindore dhe në Afrikën Veriore. Sundimi i shtetit otoman zgjati mbi pesë shekuj, apo më saktësisht, deri në mbarimin e Luftës së Parë Botërore.

Gadishulli Ballkanik shtrihet në Evropën Lindore. Banorët e tij përfshijnë një numër të madh muslimanësh, pjesa dërrmuese e të cilëve janë nga ish-vendet jugosllave, si: Bosnjë 65-70%; Maqedoni: 35-40%; Kosovë, duke përfshirë edhe etnitë 98%; Lugina e Preshevës 90%; Shqipëri 70-75%. Muslimanë, por si pakica, mund të gjesh edhe në Bullgari, Rumani dhe Greqi.

Sa i përket paraqitjes së muslimanëve në Evropën perëndimore, kjo llogaritet të jetë një dukuri e re pas Luftës së Dytë Botërore. Disa erdhën si refugjatë, por shumica prej tyre u sollën nga kolonizuesit, si fuqi punëtore,

² Sqarim: Thabit janë gjërat që nuk ndryshojnë kurrë, ato mbesin përherë ashtu siç janë. Për shembull, e vërteta dhe drejtësia janë gjëra që kërkohen gjithmonë, si objektiva të fesë islame, ngase me to ndërlihet edhe siguria e individit. Ndërsa 'mutegajjur' ose e ndryshueshme, sipas këtij shembulli, do të ishin mjetet që sigurojnë këtë siguri dhe rend (shën. i përkth.).

për të cilën Evropa kishte nevojë shumë. Sipas statistikave të fundit, shifra e muslimanëve në Evropë është 53 milionë, ndërsa në Amerikën Veriore dhe Amerikën Latine, së bashku, kjo shifër arrin në 9 milionë. Një prani më e madhe e muslimanëve është vërejtur në vitet e gjashtëdhjeta dhe shtatëdhjeta. Kanadaja ka ndjekur një politikë tjetër. Ajo ka lejuar migrimin vetëm të muslimanëve të shkolluar dhe të përgatitur profesionalisht, ndërsa politika amerikane i detyronte emigrantët që të mësonin anglishten, si dhe të kuptonin kushtetutën amerikane, kulturën, traditat dhe zakonet e tyre.

Pluralizmi fetar në perëndim - trillim

El-Vakt: Nadir Metruk: Njëpërmjet vrojtimit të gjendjes dhe pozitës së pakicave islame në Perëndim, si do të mund të na e përshkruanit pluralizmin fetar atje?

Dr. Hajredin Hoxha: Realisht, nuk mund të thuhet se ka pluralizëm fetar në Evropë, as në atë perëndimore dhe as në këtë lindore. Ose pluralizmi është ende pemë e papjekur. Në fakt, historia e tyre karshi Islamit dhe pakicave islame është e errët dhe e gjakosur. Ajo është përplot shpifje, gënjeshtër dhe akuza të shkruara nga orientalistët evropianë, me qëllim që të shtrembërohet imazhi islam. Ndërsa historia amerikane ka qenë tërësisht e kundërt. Nuk kemi fakte historike se amerikanët kanë ndërmarrë kryqëzata kundër Islamit dhe muslimanëve, sikurse që nuk kemi fakte se orientalistët e tyre veprojnë sikurse homologët e tyre evropianë, përveçse pas sulmeve të 11 shtatorit. Bazuar në këtë, mund të konstatojmë se e ardhmja e muslimanëve në Amerikë dhe ajo çfarë presin muslimanët nga populli amerikan është shumë më e mirë se ajo në Evropë dhe nga ajo që presin muslimanët prej evropianëve. Si shembull për këtë mund të marrim muslimanët e Bosnjës dhe Kosovës, të cilët u masakruan nga serbët. Madje në Evropë ka ekstremistë që thërrasin për kthimin e muslimanëve në vendet e tyre, ndërsa përpjekjet e disa qarqeve fetare për krijimin e një klime tolerance dhe transparence duket se kanë dështuar. Valët e shumta të emigrantëve muslimanë në Angli, bënë që autoritetet të ndërmarrin masa

të rrepta dhe t'i vështirësojnë procedurat për emigrantët, aq sa shumë politologë, si Enoch Powell, shprehën frikën e tyre për një luftë të mundshme civile. Këtë frikë e kishte shprehur edhe kryeministrja e atëhershme, Margaret Thatcher.

Islami i Evropës dhe zhdukja e veçorive (privatësive)

El-Vakt: Nadir Metruk: Aktualisht, bazuar në fjalët e tua që flasin për një gjendje jo të mirë, si qëndron puna e muslimanëve në Perëndim?

Dr. Hajredin Hoxha: Meqë disa autorë e ndajnë gjendjen e muslimanëve në periudhën para publikimit të librit të Selman Rushdisë dhe periudhën më pas, atëherë ne kemi të drejtë që gjendjen e tyre ta ndajmë në periudhën para 11 shtatorit dhe periudhën e mëpastajme. Po kështu, gjendja e tyre në Perëndim duhet ndarë edhe para krizës daneze dhe pas saj. Gjendja e muslimanëve ka ndryshuar shumë për të keq. Urrejtja dhe inati ndaj tyre janë shtuar shumë, ndërsa ashpërsimi i ligjeve ndaj tyre, si dhe shkelja e të drejtave të tyre kombëtare e fetare, e madje edhe njerëzore, bëhet me pretekstin e akuzave për radikalizëm dhe ekstremizëm. Sipas disa statistikave, urrejtja e amerikanëve ndaj muslimanëve, pas ngjarjeve të 11 shtatorit, është shtuar për 900%. Revista 'US News and World Report' përmendte se qeveria amerikane kishte hartuar një plan të gjerë vëzhgimi për 120 xhami dhe qendra të frekuentuara prej muslimanëve, gjoja për zbulimin e bombave të mundshme nukleare.

Burimet flasin se gjendja e muslimanëve në Perëndim është përkeqësuar akoma më tepër. Muslimanët e pafajshëm akuzohen dhe arrestohen, ndërsa feja dhe simbolet e saj përdhosen e nënçmohen si mos më keq. Vetëm para pak kohe, disa media në Danimarkë publikuar karikatura fyese për peygamberin Muhammed [*alejhissalatu ves selam*]. Kështu veproi edhe 'wikipedia', ndërsa holandezët prodhuan një film që fyente Kur'anin dhe Islamin. Nuk e di se deri kur do të vazhdojë kështu kjo gjendje, apo deri kur perëndimorët do të kthjellen nga kjo dehje dhe t'i ndalin keqtrajtimet që u bëjnë vëllezërve tanë muslimanë?!

El-Vakt: Nadir Metruk: Disa mendojnë se modeli i Islamit në Perëndim ndryshon nga modeli në vendet islame. Ata mendojnë se atje manifestohet një lloj islami evropian, që bashkon vlerat islame dhe ato perëndimore. Çfarë mendoni për këtë? Si e vlerësoni praninë islame në Perëndim, sot dhe nesër?

Dr. Hajredin Hoxha: Analistët kanë vënë re se, në Perëndim, Islami është i pranishëm në dy forma:

- a) Islami, për të cilin orientalistët hulumtojnë në qarqet e tyre akademike; dhe
- b) Islami i shtrembëruar, të cilin e njeh njeriu i rëndomtë në Perëndim. Ky Islam është deformuar nga mjetet e informimit, të cilat e paraqesin atë si të djallëzuar, johuman dhe të cilin e fajësojnë për çdo gjë që ndodh në botë.

Fatkeqësisht, koston e këtij Islami të deformuar janë duke e paguar muslimanët e pafajshëm.

Ekziston edhe një ndarje tjetër, siç nënvizojnë analistët, sipas të cilit kemi:

- a) Islami në Evropë, dhe
- b) Islami i Evropës

Domethëniet e ndarjes së parë i shtjelluam pak më parë, kur thamë se shumë muslimanë, që janë larguar nga vendet e tyre, jetojnë në Evropë në kantone apo komuna pothuajse të izoluara. E keqja e kësaj është se ata kanë qenë të izoluar nga shoqëria në të cilën kanë jetuar. Ndërsa ndarja '*Islami i Evropës*' do të thotë se Evropa, gjeografikisht, ka tipare dhe karakteristika që e bëjnë të dallojë nga gjeografia arabe apo islame. Kësisoj, ajo ka të drejtë të ketë një Islam të tipit të vet, që përshtatet me pozitën, kushtet dhe rrethanat shoqërore dhe etnike.

Konsideroj - Zoti e di më së miri - se nuk ka diç të keqe në këtë ndarje, ngase koha jonë po e dëshmon këtë të vërtetë. Këtë mund ta hasësh pothuajse në tërë botën, nga Lindja në Perëndim, ku muslimanët janë

pajtuar njëzëri për parimet bazë, porse ndryshojnë në çështje sekondare, në tradita, zakone, doke dhe mënyra të jetesës. Kjo nuk ka diç të keqe dhe ne nuk guxojmë assesi që traditat e një populli t'ia imponojmë një populli tjetër, ngase çdo popull ka karakteristikat e veta, të cilat nuk lejohet të zhduken. Islami i miratoi ato tradita të arabëve që nuk binin ndesh me Islamin, ndërsa i refuzoi gjithë të tjerat. Kjo është madhështia dhe bukuria e Islamit. Pra, duhet të bëjmë dallim ndërmjet kulturës së përgjithshme të një populli dhe fesë islame, e cila është ligj i Zotit. Po kështu, duhet ta dallojmë atë që është *thabit* nga ajo që është *mutegajjir*, domethëniet e të cilave i sqaruar pak më parë.

El-Vakt: Nadir Metruk: Kjo duket interesante dhe e rëndësishme për muslimanët që jetojnë në Perëndim. Cilat do të ishin udhëzimet tuaja për një bashkëjetesë të tyre me perëndimorët, pa shkaktuar kjo ndonjë shkelje mbi parimet që konsiderohen '*thabit*' ose të pandryshueshme?

Dr. Hajredin Hoxha: Po, përfitoj nga rasti që muslimanëve në të gjithë Evropën t'u përkujtoj disa parime dhe të vërteta që dijetarët dhe mendimtarët i kanë rrumbullakësuar, si:

Duhet ta dinë ligjin për kriterin e precizimit të asaj që është e ndryshueshme (*mutegajjir*) me atë që është e pandryshueshme (*thabit*). Pra, nuk duhet të krijohet paqartësi rreth tyre. Ky ligj është 'lëvizja dhe qarkullimi brenda kornizës së *thabitit* - të pandryshueshmes - dhe boshtit të tij.' Më qartë, koncepti islam ka bazamente dhe vlera që nuk ndryshojnë, madje as atëherë kur ndryshojnë fenomenet e jetës dhe format e manifestimit praktik të saj. Në fakt, këto ndryshime janë të varura nga bazamentet dhe vlerat e pandryshueshme (*thabit*) të këtij koncepti. Kjo nuk nënkupton ngurtësimin e dinamikës ideore dhe jetësore. Jo, ajo vetëm toleron që të lëvizet brenda kornizës së pandryshueshmes (*thabitit*). Edhe më thjesht, veshja e gruas muslimane ka gjëra që janë *thabit* (të pandryshueshme), por ka dhe të tjera që janë të ndryshueshme. '*Thabit*' është:

- 1) Që veshja të mbulojë tërë trupin, me përjashtim të fytyrës dhe duarve
- 2) Që të mos jetë e tejdukshme
- 3) Që të mos jetë e ngjashme me veshjet e burrave
- 4) Që të mos jetë tërheqëse, që t'i bëjë meshkujt ta shikojnë atë për shkak të ngjyrave ose vënies së parfumit.

Këto katër parime janë të pandryshueshme, varësisht nga koha a vendi dhe pa marrë parasysh se a jeton në fshat apo qytet, në Evropë apo Amerikë, apo kudo qoftë tjetër.

Ndërsa e ndryshueshme është përzgjedhja e formave, ngjyrës, qepjes dhe prerjes, kuptohet brenda kornizave të katër parimeve bazë, pasi Islami i dha liri gruas për ta bërë një gjë të tillë. Sigurisht Perëndimi nuk ka nevojë për traditat arabe apo lindore, përderisa nuk preket esenca e besimit. Gruaja në Perëndim nuk ka nevojë që të vishet me rroba të zeza, ngase kështu do të tërhiqte shikimin e njerëzve. Përderisa ka hapësirë edhe për ngjyra të tjera, atëherë më mirë do të ishte përzgjedhja e asaj që përshtatet më shumë me traditat e tyre. Kështu kanë dhënë *fetva*³ dijetarë të mëdhenj sauditë, si p. sh. Bin Bazi.

Po ashtu duhet të jemi vigjilent dhe syçelë edhe ndaj një çështjeje shumë të rëndësishme në Perëndim. Fjala është për atë që fetvatë të mos jenë si zogu lajmëtar që fluturon nga një vend në tjetrin. Fetvatë nuk duhet të kenë karakter përgjithësues. Përkundrazi, çdo vend duhet ta ketë qendrën e vet të fetvave, ngase ajo që mund të jetë funksionale në Lindje mund të mos funksionojë në Perëndim dhe anasjelltas, për shkak të veçorive dhe karakteristikave përkatëse.

El-Vakt: Nadir Metruk: Atëherë, a jeni duke ftuar për një bashkëjetesë të plotë në Perëndim, sidomos në nivelet ligjore dhe procedurale?

Dr. Hajredin Hoxha: Realisht, unë i ftoj muslimanët që të adaptohen me ambientet perëndimore ku jetojnë, por asnjëherë në llogari të identitetit të

³ Opinion formal, këshillues, të cilin e jep dijetari ose këshilli përkatës.

tyre islam. Ata nuk guxojnë të shkrihen dhe t'i shpërfillin vlerat dhe moralin islam. Vetëm kështu ata do të mund ta arsyetonin qëndrimin e tyre në vendet joislame.

Kur të jetë sqaruar kjo e vërtetë, atëherë nuk ka rëndësi nëse Islamin e tyre e quan evropian apo ata i thërret 'muslimanët e Evropës'. Thuaj ç'të duash ngase janë të vërtetat ato që merren parasysh e jo emërtimet dhe formalitetet.

Gazeta e pavarur bahraniane, ditore dhe politike, *el-Vakt*

Nr. 718, e xhuma, 29 Safer 1429 / 07.03.2008

Refleksione

Intervista e studiuesit kosovar Dr. Hajredin Hoxha në gazetën el-Vakt

ISLAMI DHE ROLI I TIJ NË RUAJTJEN E CIVILIZIMIT PERËNDIMOR NGA SHPËRBËRJA (3)

El - Vakt : Nadir Metruk

Në pjesën e tretë të intervistës me Dr. Hajredin Hoxha, Profesorin e Studimeve Islame në Universitetin saudian Tadjibe, do të shpalosim gjendjen e muslimanëve në Perëndim, për të bërë një vështrim të përgjithshëm të gjendjes së tyre dhe sfidave me të cilat ballafaqohen. Po kështu, Dr. Hoxha, shpalos qëndrimet e tij edhe për pakicat islame në Perëndim, të cilat - gjithnjë sipas tij - duhet të përshtaten me ligjet në fuqi në vendet ku jetojnë, përderisa atyre iu lejohet ta ushtrojnë fenë, besimin dhe moralin e tyre. Po kështu, ai zë në gojë edhe lëvizjet ekstreme që veprojnë në Perëndim kundër Islamit, duke i porositur që "t'i lënë të qetë muslimanët dhe të mos kenë frikë nga Islami, ngase ai nuk paraqet rrezik për civilizimin e tyre. Përkundrazi, Islami është ilaçi adekuat, i cili e ruan këtë civilizim nga shuarja, duke shtuar këtu se rreziku për ta vjen pikërisht nga shthurja dhe degjenerimi, i cili infektoi më parë perandorinë romake dhe bëri që ajo të shuhet njëherë e përgjithmonë. Në raportet e njerëzve me gjithësinë, ai mendon se njerëzit janë pozicionuar tërësisht në anën e

teknologjisë, duke harruar se ajo nuk është qëllimi final dhe se ajo do të duhej t'iu shërbente njerëzve, e jo e kundërta. Gjithashtu ai konsideron se shërimi i duhur i kësaj problematike konsiston në faktin se Perëndimi duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi faktorit njeri...”

El-Vakt: Nadir Metruk: Duke pasur parasysh se ju, gjeografikisht, jeni perëndimor, çfarë imazhi të perëndimorëve ndaj muslimanëve sot mund të na ofroni? Cila është gjendja e tyre në Evropë? Do të preferoja të fillojmë me Evropën perëndimore!

Dr. Hajruddin Hoxha: Sipas disa studimeve dhe hulumtimeve, muslimanët janë target i së djathtës ekstreme, ndërsa tashmë mund të themi se është ndezur lufta ndërmjet së djathtës evropiane dhe muslimanëve. Në Francë, lideri i Frontit Popullor, një djathtist ekstrem, shprehte haptazi armiqësinë e tij ndaj arabëve dhe muslimanëve, duke kundërshtuar ndërtimin e xhamive dhe duke vënë edhe moton se *'Franca është e francezëve dhe jo e arabëve dhe muslimanëve!'* Nga kjo parti lindën edhe grupe të tjera ekstreme, si ajo e neo-nazistëve.

As muslimanët e Belgjikës nuk i shpëtuan dot kësaj urrejtjeje. Fill pas ngjarjeve të 11 shtatorit, gjendja u përkeqësua, edhe pse analistët provokimet i shohin si individuale. Realisht, pretendimet amerikano-çifute, se kinse muslimanët qëndrojnë pas 11 shtatorit, kanë prodhuar efekte negative dhe kanë shkaktuar reagime negative të perëndimorëve ndaj pakicave islame në vendet e tyre. Madje kjo ka bërë që shumë vende evropiane të mobilizohen karshi raporteve me muslimanët, duke i ashpërsuar kriteret dhe procedurat në raport me muslimanët, si dhe duke i mbajtur ata nën vëzhgim. Efektet e këtyre veprimeve kanë qenë edhe me pasoja ekonomike për muslimanët, kur dihet se një numër i madh shoqatash bamirësie fondet e tyre për mbajtjen e muslimanëve të varfër i kanë pikërisht nga vendet islame.

Franca, siç duket, vuan më së shumti nga islamofobia. Parimisht, çdo musliman konsiderohet si terrorist, kështu që në këtë formë apo në një formë tjetër, duhet hequr qafe. Tashmë ky shtet i ka vënë vetes për obligim që si pjesë të strategjisë shtetërore t'i "pastrojë" xhamitë nga ligjëruesit ekstremë, të mos iu lejojë hyrjen liderëve fetarë ekstremë, si dhe të themelojë institute të veçanta për përgatitjen e imamëve dhe ligjëruesve. Holanda madje ka nxjerrë një ligj që i detyron thirrësit – predikuesit muslimanë të mësojnë medoemos gjuhën shtetërore, në mënyrë që ligjëratat e tyre të jenë në gjuhën të cilën e kuptojnë autoritetet e shtetit.

Në Spanjë janë regjistruar disa incidente racore kundër arabëve dhe muslimanëve, duke ua shkatërruar pronat dhe duke ua djegur veturat. Shkak është urrejtja e tyre ndaj çdo gjëje që është arabe dhe islame, për çka ata edhe janë të vendosur që t'i largojnë 'luftëtarët' – siç i quajnë muslimanët – nga vendet e tyre.

El-Vakt: Nadir Metruk: A vuajnë shtetet evropiane nga kjo dukuri negative karshi muslimanëve? A nuk ka shembuj më të mirë ose të paktën më pak të këqij se këta shembuj?

Konsideroj se një gjendje më e mirë është në Zvicër. Muslimanët atje shfrytëzojnë kushtet dhe rrethanat demokratike për të kërkuar nga qeveria që ta pranojë zyrtarisht fenë e tyre, që t'iu japë nënshtetësi zvicerane, pasi që tash e dy dekada, apo edhe më shumë, atje jetojnë mbi gjysmë milion muslimanë nga pakicat shqiptare, turke, boshnjake, arabe, aziatike etj.

Sa i përket stabilitet dhe pozitës së mirë që gëzojnë atje, muslimanët i detyrohen faktit se janë integruar në shoqërinë zvicerane duke u bërë pjesë e saj. Mentaliteti i tyre tashmë nuk funksionon si një refugjat, azilant, por si një qytetar. Megjithëkëtë, populli zviceran, për shkak të shtrembërimit të imazhit islam, beson në përplasjen e qytetërimeve.

Veçoritë e muslimanëve në Ballkan

El-Vakt: Nadir Metruk: Folët për gjendjen e muslimanëve në Evropën perëndimore, por, për shkak se ju vetë jeni nga Evropa lindore, atëherë do të donim të dinim për gjendjen e muslimanëve atje, sidomos tash kur dihet se kjo zonë ka përjetuar një ndryshim gjeopolitik, i cili s’do mend se ka ndikuar edhe te muslimanët, në kulturën dhe civilizimin e tyre.

Dr. Hajruddin Hoxha: Është shkruar shumë për këtë çështje, si nga perëndimorët po ashtu edhe të tjerët, por këtyre shkrimeve iu mungon objektivizmi. Shihet se shkrimet kanë qenë ‘me porosi’ për misionarët e krishterë, gjë që ka bërë që muslimanët t’i marrin ato me rezervë dhe dyshim. Alija Izetbegović, ish-president i BeH-së, pati përmendur se muslimanët boshnjakë dhe shqiptarë dallojnë nga muslimanët e vendeve evropiane, për shkak se nuk janë pakica por janë autoktonë dhe shumicë, gjë që do të duhej të ndikonte që atyre t’iu kushtohet më shumë rëndësi. Për këtë ndoshta do të mjaftonte si motiv fakti se këta muslimanë kanë hequr të zitë e ullirit për dekada të tëra për ta ruajtur fenë e tyre. Rasti i fundit ishte ai i presidentit serb, Slobodan Millosheviç, i cili, në emër të ortodoksizmit, për të bërë një pastrim etnik dhe fetar, zhvilloi një luftë të hapur frontale, rezultat i së cilës ishin dhjetëra mijëra të vrarë, të masakruar, të zhdukur dhe invalidë.

Organizimi i takimeve fetare brenda ligjit perëndimor

El-Vakt: Nadir Metruk: Duke shikuar krizën ideore, fetare dhe shoqërore që ka kapluar mbarë botën, çfarë mendoni se duhet të bëjnë pakicat islame dhe shoqëritë perëndimore, apo si duhet të bashkëveprojnë ato në mënyrë që muslimanëve t’iu sigurohet një ekzistencë e qetë?

Dr. Hajruddin Hoxha: Mendoj se që të gjithë duhet të punojnë për të forcuar raportet ndërfetare dhe ndërkulturore. Organet shtetërore të vendeve perëndimore duhet t’i trajtojnë me seriozitetin më të madh kërkesat, ankesat dhe propozimet e muslimanëve. Ata duhet të pranojnë se Perëndimi i është borxhli muslimanëve në aspektin shkencor dhe kulturor, e në këtë kontekst, ata duhet t’ua njohin atyre të drejtën e shkollimit fillor,

parauniversitar dhe universitar. Po ashtu, ata duhet ta largojnë idenë e fundamentalizmit nga fjalori i tyre. Ata duhet t'i trajtojnë muslimanët si të barabartë me gjithë të tjerët dhe nuk duhet të miratojnë ligje që shkelin fenë apo parimet e fesë së tyre. Gjithsesi ata nuk duhet të ndjekin shembullin e ministrit të arsimit në Francë, i cili i detyroi 700 vajza muslimane me mbulesë që t'i hiqnin shamitë e tyre nën kërcënimin e përjashtimit nga shkolla. Muslimanët e rinj, që po shtohen nga dita në ditë si praktikues të islamit, nuk duhet të trajtohen me paragjykime. Atyre duhet t'iu lejohet mbajtja e takimeve dhe tubimeve fetare, por kuptohet që aktivitetet e tyre duhet të jenë brenda ligjit të shtetit ku jetojnë.

El-Vakt: Nadir Metruk: E vërtetë, pakicat islame dhe aktivitetet islame janë në rritje e sipër. Cila është këshilla juaj për këto pakica që ta fuqizojnë ekzistencën e tyre por edhe që t'i realizojnë qëllimet e thirrjes së tyre?

Dr. Hajruddin Hoxha: Pakicat islame në Perëndim duhet të funksionojnë si një formacion i bashkuar, i cili ka qendrën vendimmarrëse por edhe përfaqësimet lokale, ngase kështu përcimi i zërit të tyre tek organet kompetente do të ishte më i lehtë. Në anën tjetër, dijetarët, hoxhallarët dhe thirrësit muslimanë do të duhej të ishin më të vëmendshëm karshi faktit se janë pakicë, se jetojnë në shtete joislame dhe rrjedhimisht duhet t'i respektojnë ligjet në fuqi të shtetit përkatës. Nuk lejohet rebelimi dhe as nuk duhen dëgjuar ata që japin fetva të tilla, siç ishte rasti në Holandë, kur disa dhanë fetva për ndalimin e pjesëmarrjes në zgjedhje për shkak se nuk kishin nënshtetësi holandeze dhe se kandidatët ishin nga radhët e jomuslimanëve.

Po ashtu them se pakicat tona duhet të njihen më shumë me kulturën dhe historinë e vendit në të cilin jetojnë. Teoria e Samuel Huntingtonit për 'përplasjen e qytetërimeve' nuk duhet të pranohet. Përkundrazi, nëse do të duhej të pranohej ndonjë teori perëndimore, atëherë do të ishte ajo e Brian Beedham, i cili mendon se e ardhmja do t'i gjejë muslimanët dhe të krishterët më të bashkuar se më parë.

El-Vakt: Nadir Metruk: Mendoj se ka dhe një problem tjetër që duhet diskutuar këtu: prezantimi i Islamit në Perëndim - që siç e dimë është shumë i avancuar shkencërisht - nga muslimanët që realisht nuk janë shumë të shquar për njohuri, sidomos për këto bashkëkohoret. Cili është komenti juaj për këtë?

Dr. Hajruddin Hoxha: Krahas asaj që përmendëm më parë, mendoj se mbetet obligim imediat për muslimanët, veçanërisht ata që jetojnë në Perëndim, që të bëjnë një përputhje ndërmjet Islamit, shkencave shoqërore dhe teknologjisë moderne, dhe këtë ta realizojnë nëpërmjet nismës së islamizimit të shkencave dhe njohurive. Kështu jo vetëm që do të mundësohej përputhja, por gjithashtu edhe identiteti islam do të ruhej i paprekur nga sfidat e kohës. Sigurisht, kjo do të mbetet vetëm ide dhe nuk do të realizohet kurrë nëse nuk kemi hapur më parë derën e ixhtihadit dhe përtëritjen e diskursit fetar, sidomos në Perëndim. Kështu do të mund t'i bënim ballë sfidave të kohës. Mendoj se nuk duhet të mjaftohemi kurrsesi me kontributet e qindra viteve më parë. Muslimanët, kam përshtypjen, kanë filluar të kuptojnë se tefsiret e mëparshme janë hartuar për shoqëri në të cilat muslimanët ishin shumicë, ndërsa tash ka lindur nevoja për tefsire kur muslimanët janë pakicë. Natyrisht, kjo nuk realizohet vetvetiu. Ka nevojë për ixhtihad dhe punë të thellë shkencore.

El-Vakt: Nadir Metruk: Tashmë ka filluar të flitet për një kulturë perëndimore të tipit urrejtës. Është kulturë e shkëmbyer ndërmjet muslimanëve dhe perëndimorëve. Çfarë mund të na thoni për të?

Dr. Hajruddin Hoxha: Natyrisht, zgjidhja e problemit nuk qëndron këtu. Me këto ndjenja armiqësore për njeri-tjetrin, ata nuk do të arrijnë kurrë paqen. Andaj, duhet të punohet shumë që të krijohen raporte të ndërsjella. Mendoj se kjo nuk paraqet problem për të kumtuar fenë origjinale ashtu siç është. Islami e sheh njerëzimin si një familje të zgjeruar, me raca dhe gjuhë të ndryshme, por me zanafillë të njëjtë.

O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre të dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë All-llahun që me emrin e Tij përбетoheni, ruajeni farefisën (akraballëkun), se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju.” (en-Nisa: 1)

O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që është ruajtur më tepër (nga të këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësishtë i njohur për çdo gjë.” (el-Huxhurat: 13)

Bazuar në këtë, mbetet obligim që perëndimorët, por dhe pakicat tona atje, t'i vetëdijesojmë karshi të vërtetave të Islamit. Atyre duhet t'iu bëhet e qartë se Islami është tolerant, se ai e fal tjetrin, se e ndalon sharjen, fyerjen dhe nënçmimin e tjetrit, siç thotë Allahu në Kur'an:

Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos All-llahut, e (si hakmarrje) të fyejnë All-llahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne ia kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan.” (el-En'amë: 108)

Pakicat islame do të mund të pajtoheshin me perëndimorët për përhapjen e moralit të mirë, për luftimin e dukurive devijante etj. Ka tokë të përbashkët, të cilën mund ta punojnë të dyja palët.

Përgjegjësitë e pakicave islame në Perëndim

El-Vakt: Nadir Metruk: Për fund, cilat mendoni se janë përgjegjësitë që duhet t'i bartin pakicat islame mbi supet e tyre në shoqëritë perëndimore në të cilat jetojnë?

Dr. Hajruddin Hoxha: Përgjegjësitë janë të shumta. Duke u nisur nga parimi i sinqeritetit dhe përmbushjes së premtimit, besimtarët e kanë për obligim që të mirat e Perëndimit t'i kthejnë me të mira. Respektivisht, ata nuk duhet të tregohen koprracë me dijet, njohuritë, kulturën dhe civilizimin që

kanë, për të cilat besoj se Perëndimi ka shumë nevojë. Nëse pakicat vuajnë nga mungesa e të mirave materiale, perëndimorët vuajnë nga sëmundje shpirtërore, të cilat Islami do t'i zgjidhte me shumë sukses. Ka ardhur koha që muslimani ta luajë rolin e tij për ta shpëtuar njerëzimin nga humnera. Besimtari duhet ta prezantojë veten në shoqëritë perëndimore ashtu si është, me identitet islam të pashtrembëruar, në mënyrë që sjelljet e tij të jenë përkthim origjinal i Islamit. Kështu muslimani do t'ua jepte shansin perëndimorëve që të njihen nga afër me Islamin dhe në këtë mënyrë dialogët ndërkulturorë do të kishin botëkuptimet e duhura.

Besimtarët duhet të integrohen në shoqëritë perëndimore jo nëpërmjet shkrires dhe asimilimit, por me moral dhe edukatë të lartë, gjë që do t'i detyronte perëndimorët t'i respektonin ata. Pakicat duhet t'i respektojnë ligjet e shteteve në të cilat jetojnë, përderisa ato janë ligje që e nderojnë njeriun si qenie dhe iu garantojnë siguri dhe mirëqenie. Ky është modusi i përbashkët ndërmjet Islamit dhe atyre ligjeve.

DREJT NJË METODOLOGJIE DINAMIKE DHE APLIKATIVE NË KOMENTIMIN E KUR'ANIT FISNIK

Tefsiri, që nga koha e sahabëve [*Allahu qoftë i kënaqur me ta*] e deri më sot, ka kaluar nëpër disa etapa, gjë që rezultoi me ndryshimin e rrjedhës së tefsirit dhe shfaqjen e qasjeve, metodologjive dhe leximeve të ndryshme koherente, për t'u përshtatur dhe përputhur me disa mendimtarë dhe shkencë të kohës apo etapës përkatëse.

'Leximet bashkëkohore' nënkuptojnë aplikimin e teorive të reja në komentimin e Kur'anit, të cilat çojnë në shtrembërimin e domethënies dhe botëkuptimeve kur'anore, si dhe në shpërputhjen e tyre (komenteve) me të vërtetat dhe objektivat islame. Shkak i paraqitjes së këtyre ideve çoroditëse dhe drejtimeve devijante sigurisht se është mishërimi i këtyre komentuesve me metodologjitë dhe lëvizjet perëndimore, mosrespektimi i shenjtërisë së Kur'anit dhe i specifikave retorike dhe gjuhësore të tij, si dhe konsiderata se tekstet kur'anore janë sikurse edhe tekstet e tjera të rëndomta.

Ithtarët e këtyre drejtimeve ftuan në humanizmin e tekstit kur'anor dhe peygamberik (të llogariturit e tekstit kur'anor si produkt njeriu), në racionalizëm (nënshtrimin ndaj logjikës) dhe periodizim (lidhjen dhe komentimin e tyre vetëm me rastet kur janë shpallur, pra gjoja se ato janë tekste që i përkasin historisë, së kaluarës, dhe se për kohën tonë nuk janë të aplikueshme.) Ata e bënë këtë për të arritur gjoja në konkluzionin se Kur'ani lidhet me ngjarje të caktuara historike dhe se ai është vetëm një prej teksteve të shumta të përpiluara nga njeriu. Për këtë shkak, ata kanë përdorur edhe terminologji të reja, të ndryshme nga ato tradicionalet, si: epistemologjia, empirizmi, antologjia etj, ndërsa Kur'anin të pafetë e emërtuan 'Kodi i madh' (el-mudevveneh el-kubra), kurse ajetet e tij i quajtën 'frazat' (ar. el-ibarat.)

Pa dyshim kjo shkollë është një vazhdimësi e shkollave të menaxhuara nga orientalistët, të cilët peygamberinë e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] e

panë vetëm si një hallkë të re të fesë çifute dhe të krishtere (dhe jo se ai ka sjellë ndonjë ligj të ri hyjnor, pra e mohuan pejgamberinë e tij.)

Metodologji e kësaj shkolle është kontrolli mbi tekstin kur'anor, manipulimi me të (pra humbja e shenjtërisë së tij) dhe komentimi i tij sipas disa mjeteve metodologjike dhe shprehjeve të huaja të paqarta, të cilat janë rrënjësisht në kundërshtim me rregullat dhe metodat e gjuhës arabe. Prej pionierëve (famëkeq) që bartin flamurin e kësaj shkolle janë shekullaristi algjerian Muhammed Erkon, marksisti sirian Muhammed Shahrur, socialisti marokian Muhammed Abid el-Xhabirij, mu'tezilisti egjiptian Hasen Hanefij, tuniziani Abdul Mexhid Sherefij, komunisti sirian me prejardhje turke Xhelal Sadik el-Adhm etj.

Vërtet, ummeti sot ka nevojë, më shumë se kurrë më parë, që ta riformulojë Tefsirin nga fillimi, ta nxjerrë atë nga margjinat e kundërthënieve të brendshme, ta lirojë nga presionet negative dhe të ngjallë në të shpirtin e misionit udhëheqës dhe zhvillimor në tokë. Tefsiri i dëshiruar është ai që e nxjerr ummetin nga zgjedha e prapambetjes dhe e vendos atë në karvanin e zhvillimit kulturor, industrial dhe teknologjik. Pa dyshimin më të vogël, këto nisma të reja për komentimin e Kur'anit kanë për të dështuar, për shkak të injorancës së tyre në raport me Kur'anin, me veçoritë e tij gjuhësore, metodat e tij retorike, botëkuptimet e tij madhështore dhe metodologjitë e duhura dhe të sakta të komentimit.

Metodologjia të cilën Sejjid Kutbi e quan 'Metodologjia dinamike', në të cilën ne po ftojmë, meriton t'i kushtohet vëmendje e posaçme dhe të përvetësohet si metodologji në komentimin e Kur'anit, nëse ne i vëmë vetes detyrë që ta nxjerrim ummetin nga gjendja në të cilën është.

Ndërsa sa i përket natyrës dhe domethënies së kësaj metodologjie aplikative dhe dinamike, Sejjid Kutbi na sjell sqarime në disa nga veprat e tij, e sigurisht edhe në Tefsirin e tij, madje në disa vende. *"Çështja në të kuptuarit e domethënieve dhe inspirimeve të këtij Kur'ani... ka të bëjë me një përgatitje shpirtërore me një fond ndjenjash, perceptimesh dhe përvojash, që i*

ngjajnë ndjenjave, perceptimeve dhe përvojave që shoqëruan shpalljen e tij dhe jetën e muslimanëve të parë, të cilët e pranonin atë në mesin e betejës, betejës së xhihadit, xhihadit të nefsit dhe xhihadit të njerëzve... xhihadit të epsheve dhe xhihadit të armiqve... në atmosferën mekase të thirrjes së sapoformuar, në atmosferën e varfërisë dhe dobësisë, izolimit dhe bllokadës, urisë dhe embargos, frikës dhe internimit, shkëputjes dhe lëçitjes nga çdo gjë tjetër përveç Allahut... Pastaj në ambientin medinas, në klimën e shtetndërtimit të parë islam, apo formimit shoqëror të muslimanëve ndërmjet kurtheve dhe hipokrizisë... në këtë klimë në të cilën u shpallën ajetet kur'anore të gjalla, aktive dhe aktuale... Kështu, fjalët dhe frazat kishin domethëniet, mësimet dhe inspirimet e tyre... Vërtet, natyra e kësaj feje e refuzon reduktimin e informacioneve të ftohta (të pavlera) në frigoriferët e mendjeve të ngurta... Dija në këtë fe transformohet në dinamikë – lëvizje, ndryshe ajo nuk ka përkatësi të kësaj feje. Pikërisht për këtë shkak edhe dispozitat fetare janë shpallur në Medinë, si lëvizje, gjallëri dhe dinamizëm në shoqërinë islame të formuar atje, përkundër Mekës, ku nuk është shpallur madje as edhe një dispozitë e vetme, për të mos u deponuar si 'dije e ngurtë' derisa t'i vijë koha për t'u zbatuar në praktikë në Medinë. Dija për dijen nuk është metodologji islame. Dija, në Islam, është për t'u vënë në lëvizje, dija është për të vepruar, është kredoja për jetë... Natyra e metodologjisë dinamike islame parasheh që aktualiteti njerëzor të ballafaqohet me një lëvizje ekuivalente me të apo edhe dominante ndaj saj, në etapa të caktuara me mjetet përkatëse. Kjo edhe për shkak se përderisa injoranca (xhahilijeti) nuk kufizohet thjesht në një teori, por në një kompani lëvizjeje të kësaj natyre, atëherë edhe përpjekjet për anulimin dhe zhdukjen e saj si dhe kthimin e njerëzve në fenë e Allahut nuk duhet të kufizohen vetëm në teori. Kështu ajo nuk do të ishte ekuivalente me injorancën e shprehur në formën e një formacioni të organizuar... Gjenerata e parë u krijua (formua) në frymën e metodologjisë së përvetësimit (të dijeve) për veprim dhe zbatim, ndërsa gjeneratat e ardhshme erdhën si rezultat i metodologjisë për marrje (mësim), për studim dhe dëfrim..."

Allahu e mëshiroftë profesorin tonë, ndërsa përshëndetjet, si gjithmonë, qofshin për Muhammedin, familjen, shokët dhe pasuesit e tij!

TERRORIZMI, SFONDI I TIJ HISTORIK DHE LËÇITJA E ISLAMIT PREJ TIJ

Historikisht, bazuar në disa studime bashkëkohore, fjala terrorizim është përdorur për një lloj pushteti të përvetësuar nga revolucioni francez në periudhën e Republikës Jakobiane (Jacobin Republic), në vitet 1793-1794, kundër paktit të dy mbretërve borgjezë që ishin kundër revolucionit. Si rezultat i terrorizmit të kësaj periudhe, e cila quhet “Reign of Terror” (Epoka e terrorit), u arrestuan 300.000 të dyshimtë dhe u ekzekutuan afër 17.000 të tjerë, duke mos llogaritur këtu mijëra të burgosur që vdiqën nëpër burgje.

Sipas disa studiuesve, terrorizmi ka ekzistuar shumë më herët, madje gjatë gjithë historisë njerëzore, në të gjitha anët e botës. Historiani grek Ksenofon (30-34 para Isait) kishte shkruar për nxitjet shpirtërore për luftë dhe terror ndaj popujve. Ai kishte folur për pushtetarë romakë, si: Tiberius (14-37 p. I.), Kaligula (37-41 p. I.), të cilët i kishin nënshtruar nëpërmjet dhunës, konfiskimit të pasurisë dhe ekzekutimit ata që e kundërshtonin pushtetin e tyre. Ndoshta inkuizicioni që bënë spanjollët ndaj pakicave fetare, e në veçanti ndaj asaj muslimane, ishte prej stacioneve më të rëndësishme të terrorizmit në historinë e kulturës perëndimore.

Disa shtete e kishin përvetësuar terrorizmin si pjesë të strategjisë politike të shtetit, si p.sh.: Hitleri nazist në Gjermani dhe Stalini në ish-Bashkimin Sovjetik. Nga këndvështrimi perëndimor, organizata dhe lëvizje të tilla si: Bader Majenhof në Gjermani, ushtria e kuqe japoneze, ushtria republikane irlandeze, Bask Eta etj., janë llogaritur ndër organizatat më të njohura të terrorizimit në historinë e shekullit të XX-të.

Terrorizmi dhe fundamentalizmi si dhe rrënjët e tyre fetare

Kohët e fundit është shfaqur një dukuri e re në formë dhe ngjyrë, por e vjetër në rrënjë dhe ekzistencë. Sipas studimeve flitet se rastet më të vjetra

të njohura si terroriste janë regjistruar nga një sekt fetar çifut, SCAR II, i cili ishte sekt ekstrem dhe që për sulmimin e armiqve përdorte taktika të panjohura. Zakonisht preferonin sulmin gjatë ditëve festive....

- Disa historianë mendojnë se rrënjët e terrorizmit konkret dhe ideor zënë fill tek ideja e sionizmit çifut. Këtë gjë e kanë vërtetuar në bazë të filozofisë sioniste e cila mbështetet në këto baza:

- Çifutët janë populli i zgjedhur i Allahut. Shpirtrat e tyre dallojnë nga shpirtrat e njerëzve të tjerë, të cilët kanë shpirtra djajsh dhe të ngjashëm me ata të kafshëve. Izraelitet janë më të nderuar se edhe vetë engjëjt...
- Tërë dynjaja është pronë e çifutëve dhe mu për këtë ata kanë të drejtë ta mbizotërojnë atë.
- Palestina është synimi kryesor i çifutëve, ngase ajo është tokë e shenjtë, është tokë e ringjalljes dhe si e tillë iu takon vetëm atyre...
- Çifutët kudo që janë përbëjnë vetëm një popull dhe kanë vetëm një bazë, e ajo është toka e Palestinës.

- Mendohet se kjo dukuri u regjistrua pas zbulimit të kontinentit amerikan, në fund të shek. XV-të. Shoqëria amerikane u ndërtua në baza racore, burim i të cilave ishte ideja fetare çifute, e cila kishte depërtuar nëpërmjet puritanëve britanikë. Bazuar në këtë bazë historike fetare çifute, mbi të cilën ishte themeluar Amerika veriore, amerikanët e panë veten si misionarë të mesazhit fetar botëror dhe e konsideruan veten si Izraeli i ri, që Allahu i zgjodhi ta luajnë rolin e udhëheqësit të botës...

Terrorizmi dhe Islami

Edhe pse thuhet kështu për zanafillën e kësaj dukurie megjithatë, gjatë shtjellimit dhe analizave të ndryshme, vijmë deri tek konkluzioni se kjo dukuri shtrihet shumë larg, përtej këtyre kufijve kohorë që u përmendën më lart. Zanafilla e saj buron nga konflikti i bijve të Ademit, [*alejhi's selam*], njeriut të parë në tokë. Allahu thotë:

Lexoju (Muhammed) atyre (jehudive e të tjerëve) ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbane, nga të cilët njërit iu pranua. Ai (që nuk iu pranua) tha: “Unë do të të mbys ty” (Kabili i tha Habilit). E ai (që iu pranua) tha: “All-llahu pranon vetëm prej të sinqertëve”. (el-Maide: 27)

Pastaj këtë dukuri e trashëguan çifutët dhe të krishterët, të cilët vranë e masakruan peygamberë e të dërguar të Allahut. Kur’ani i ka regjistruar këto vepra të shëmtuara të këtyre njerëzve, të cilët i mbytnin peygamberët pa asnjë të drejtë. Allahu thotë:

Dhe kur atyre u thuhet: “Besoni atë që e shpalli All-llahu”, ata thonë: “Ne besojmë atë që na u shpall neve”, kurse e mohojmë atë pas tij, edhe pse është vërtetues i atij që e kanë ata dhe është i vërtetë. Thuaj: “Nëse jeni besimtarë, pse pra i mbytnit më parë peygamberët e All-llahut?” (el-Bekare: 91)

Atyre (jehudive) u është vënë njollë e nënçmimit kudo që të gjenden, vetëm nëse kapen për litarin (fenë) e All-llahut dhe kthehen në besën e njerëzve (të muslimanëve). Ata kanë shkaktuar kundër vetes përbuzje nga All-llahu, andaj atyre u është shtruar shtypja e mjerimi. Këtë, për shkak se ata i mohonin argumentet e All-llahut, i mbytnin mizorisht peygamberët dhe për shkak se kundërshtonin (udhëzimet e Zotit) dhe tejkalonin (çdo normë njerëzore).“ (Ali Imran: 112)

Edhe përkitazi me historinë islame janë shënuar incidente apo akte të tilla terroriste. Qysh prej fillimit të shkëndijave të para të fesë islame, predikuesi i saj, Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] dhe shokët e tij, i ishin ekspozuar terrorizmit, mundimit, persekutimit, maltretimit, që shkaktuan edhe migrimin dy herë në Etiopi e së fundi edhe në Medine. Pastaj bllokada ekonomike dhe shoqërore për hashimitët, komploti i organizuar kundër Muhammedit, [*alejhis salatu ves selam*] pak para hixhretit, për të vazhduar pas hixhretit me luftëra e beteja të mëdha, janë dëshmi për këtë terror të dhunshëm. Po ashtu, skenat e këtij terrori nuk u ndalën as pas vdekjes së

Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]; u vranë mizorisht Omeri, Uthmani dhe Aliu, tre prej katër halifëve të drejtë.

Ky skenar i hidhur i këtij terrori, me forma dhe mënyra të ndryshme, sot, kthehet dhe përsëritet me pushtimet dhe kolonizimet që iu janë bërë vendeve tona islame nga armiq, që gjuhë të vetme kanë tanket, bombarduesit F-16 dhe armë të tjera.

ISLAMI NDËRMJET APROVIMIT TË MESATARES DHE REFUZIMIT TË TERRORIZMIT ME TË GJITHA FORMAT E TIJ

Islami nuk ka as edhe një lidhje të vetme me terrorizmin, ndërsa terminologjitë, si: *'Islami politik', 'Islami progresiv', 'Islami tradicional', 'Islami popullor', 'Islami fundamental', 'Islami radikal', 'Islami militant', 'Ringjallja islame', 'Ripërtëritja islame', 'Islami i rreptë', 'Dhuna islame', 'Terrorizmi islam'* etj., nuk kanë asgjë të përbashkët me të. Ato, në fakt, janë pjellë e orientalistëve, të cilët, për të fituar simpatinë e burrështetasve dhe liderëve politikë, kuptohet që kanë qëndrim të ashpër ndaj Islamit dhe muslimanëve, prandaj shpikin dhe thonë gjëra të paqena për Islamin.

Në Islam nuk ka dëm fillestar dhe as dëmtim reciprok

Me gjithë shkaktimin e këtyre të këqijave, këta faqezinj nuk e ndiejnë veten fajtorë. Përkundrazi. Ata shtiren sikur nuk kanë asnjë faj dhe se çdo e keqe që ekziston – gjithnjë sipas tyre – ka për adresë Islamin. Sikur askush përveç muslimanëve nuk është terrorist!

Zhvleftësimin e këtyre akuzave të pabaza ndaj Islamit do ta bëjmë nëpërmjet pikave vijuese:

Së pari, dua të përmend disa të vërteta fetare dhe disa parime fundamentale sheriatike, te të cilat dijetarët tanë të mëdhenj arritën pas analizave dhe përpjekjeve të mëdha shkencore. Në këtë kontekst, do të doja të veçoja:

1) Rregulla fetare, si: “لا ضرر ولا ضرار” (*Nuk ka dëm fillestar dhe as dëmtim reciprok*); “الضرر يزال بقدر الإمكان” (*Dëmi largohet sipas mundësisë*); “الضرر لا يزال

بضرر مثله أو أكبر منه” (Dëmi apo e keqja nuk largohet me një të keqe të ngjashme apo me më të madhe se ajo); “يحتمل الضرر الأدنى لدفع الضرر الأعلى” (Përballohet dëmi i vogël për të larguar atë të madhin).⁴

2) Tekste kur'anore, si:

Për këtë (shkak të atij krimi) Ne u shpallëm (ligj) beni israilëve se kush mbytur një njeri (pa të drejtë), që nuk ka mbytur ndonjë tjetër dhe që nuk ka bërë ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur të gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit. Atyre (beni israilëve) u erdhën të dërguarit Tanë me argumente, mandej edhe pas këtij (vendimi) shumë prej tyre e teprojnë (kalojnë kufijtë në mbytje) në këtë tokë.” (el-Maide: 32)

Në qoftë se ata anojnë nga paqja, edhe ti ano nga ajo e mbështetu tek All-llahu. Ai dëgjon dhe di.” (el-Enfalë: 61)

All-llahu thërret për në xhenet dhe atë që do e vë në rrugë të drejtë.” (Junus: 25)

...Pajtimi është më i dobishmi...” (en-Nisa: 128)

Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju pajtojini ata, e në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftojeni atë grup që vërsulet pa të drejtë, derisa t'i bindet udhëzimit të All-llahut, e nëse kthehet, atëherë bëni pajtimin ndërmjet tyre me drejtësi. Mbajeni drejtësinë, se vërtet All-llahu i do të drejtësi.” (el-Huxhurat: 9)

...Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e jo në mëkate e armiqësi...” (el-Maide: 2)

3) Tekste profetike, si:

⁴ Për më shumë shih: *El-Muvafekat fi-sh-Sheriati-l-Islamijeh* të Imam Shatibiut; *El-Kavaid el-fikhijje* të Abdul Aziz Muhammed Azamit; *Mubaderetu vakfi-l-unf - ru'jetun vakijjetun ve nadhretun sherijjetun* të Usame Ibrahim Hafidhit etj.

Kush rebelohet dhe largohet nga kolektivi, dhe vdes në këtë gjendje, vdes si në periudhën e injorancës. Kush lufton nën flamurin e injorancës (nuk e di se për çfarë lufton), hidhërohet për hir të farefisit, thërret në të (fanatizëm farefisnor) apo përkrah një gjë të tillë dhe (në këtë gjendje apo me këto bindje) vritet, atëherë vdekja e tij është si në periudhën e injorancës. Ndërsa kush çohet nga ummeti im dhe godet të mirin e të keqin, pa u interesuar fare për besimtarët e tij (ummetit) dhe pa e përfillur besën e atyre që iu është dhënë besa, ai nuk është prej meje dhe unë nuk jam prej tij!" (Muslimi)

Nuk i lejohet muslimanit ta frikësojë muslimanin!" (Transmeton Ebu Davudi, ndërsa Albani e vlerëson si hadith autentik.)

...kështu që i Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam] ndaloi që të frikësohet besimtari dhe t'i merret plaçka, qoftë për shaka, qoftë përnjëmend!" (El-Mustedrek ala-s-sahihajni, vëll:3, f. 476, nr. 5778.)

Islami është fe e paqes dhe sigurisë

Duke u bazuar në rregullat fetare dhe tekstet kur'anore e pejgamberike të cituara më parë, themi se çdo dëm, pavarësisht se a është fizik a kuptimor, që godet individin apo shoqërinë, sikurse që është sot terrorizmi, ndalohet. Shqetësimi i njerëzve të pafajshëm dhe përhapja e panikut ndërmjet tyre janë gjeste dhe veprime që Islami i urren dhe i ndalon. Kështu, për të mos rënë në këtë humnerë, Islami thërret që të përvetësojmë metodologjinë kur'anore, me qëllim që t'i sfidojmë fuqishëm këto probleme prej të cilave vuajnë njerëzit, kafshët por edhe bota bimore.

Islami është fe e paqes dhe sigurisë, është fe e jetës, është fe e ndërtimit dhe zhvillimit, është fe që i ka vënë vetes si mision që të ruajë dhe të kujdeset për të mirat e njerëzimit, në këtë botë dhe në botën tjetër. Islami nuk është fe e vrasjes, mbytjes, terrorizmit, vdekjes, ashtu siç perceptohet nga disa injorantë. Këtu mbase qëndron edhe sekret i luftës së pa kompromis të Islamit ndaj dukurisë së ekstremizmit, radikalizmit dhe fanatizmit, që çon në terrorizëm dhe në akte kriminale të mëdha. Për këtë shkak, Kur'ani na

thërret vazhdimisht që t'i referohemi epiqendrës⁵, Kur'anit dhe Sunnetit, për të marrë këshilla dhe rekomandime për mënyrën e zgjidhjes së problemeve të tilla. Dijetarët e mëdhenj të ummetit, përgjatë gjithë historisë, kanë deklaruar njëzëri se objektivat e kësaj feje të natyrshme janë vënë për të mbrojtur çështjet e mëdha që kanë të bëjnë me njeriun, pa të cilat jeta e tij nuk ka kuptim. Këto janë gjëra që askush nuk guxon t'i cenojë. Fjala është për ruajtjen e *'fesë, qenies, mendjes, nderit dhe pasurisë.'*

Këto pesë gjëra njihen nga dijetarët si *'pesë të domosdoshmet.'*⁶

Kësisoj, pas këtij këndvështrimi islam, nuk është vështirë të konstatohet se dukuritë e terrorizmit, vrasjes së njerëzve të pafajshëm, panikut, frikësimit, nuk kanë të bëjnë fare me Islamin dhe ato janë në kundërshtim të madh me mësimet dhe edukatën e tij. Mu për këtë, dijetarët e ummetit janë unikë sa i përket mbajtjes së mesatares (qëndrimeve të balancuara) në të gjitha çështjet e fesë, ani pse mund të ketë ndonjë mendim ndryshe, por që nuk merret për bazë. Të gjithë ata që kundërshtojnë mesataren islame janë të gjykuar të dështojnë dhe të kenë fund të padëshiruar.

⁵ Shih: Fettah, Irfan Abdul Hamid. (2000) *Lectures on Major Themes in World Religions*. Malajzia: Universiteti Ndërkombëtar Islam.

⁶ Për më shumë shih: El-Muvafekat të Shatibiut, f. 219-255.

RADIKALIZMI DHE EKSTREMIZMI I TË RINJVE PËR SHKAK TË MUNGESËS SË DIJES DHE NJOHURIVE

Në artikujt e mësipërm shpjeguar domethënien e terrorizmit dhe sfondin historik të tij, duke shtuar se ai nuk ka asgjë të përbashkët me Islamin. Në këtë artikull do t'i trajtojmë radikalët dhe ekstremistët nga një këndvështrim tjetër, që në fakt është karakteristika më e theksuar e tyre. Derisa jemi këtu, konsideroj se ia vlen të sjellim diç nga analiza e një mendimtari islam, i cili flet për situatën aktuale dhe vështirësitë e të kuptuarit të saj. Në fakt, ne do të shkëpusim disa nga thëniet dhe mendimet e tij, e më pas do të japim edhe komentet tona. Fjala është për Abdul Kerim Bekkarin, i cili në librin e tij *'Asruna ve-l-ajshu fi zemanih-i-sa'b'*, f. 21-23, thotë: *"Për të bërë një jetesë të pranuar dhe efikase në kohën tonë, hapi i parë që duhet bërë është të kuptuarit e saj (hapërimi me kohën apo të qenit në trend me të.) Koha dhe aktualiteti në të cilën jemi nuk janë të thjeshta. Në fakt, aktualiteti ynë i ngjan shumë asaj që filozofët e quajnë 'materie', e ndonjëherë është i ngjashëm me 'zhivën', e cila të nënshtrohet (është e lehtë për t'u përvetësuar) por që kurrë nuk mund t'i japësh formë apo ta konkretizosh në diç, që do të thotë se butësia dhe elasticiteti i saj janë mashtrim. Kështu është puna jonë me zhvillimet dhe ngjarjet e kohës sonë. Në kohën kur shumica e njerëzve pretendojnë se kuptojnë dhe janë të vetëdijshëm për atë që ndodh, del dikush dhe thotë se në fakt njerëzit nuk janë duke kuptuar asgjë. Ajo që thuhet dhe publikohet të jep një përshtypje plotësisht të ndryshme nga ajo që ndodh në të vërtetë. Ajo që unë besoj se është shkak pse njerëzit kanë probleme të mëdha në të kuptuarit e realitetit dhe kohës është se ata nuk mund ta kuptojnë realitetin përveçse nëpërmjet një strukture njohurish dhe idesh të përbërë nga tri elemente kryesore:*

- *Bindjet dhe vlerat e tyre*
- *Kompozimet mendore*
- *Njohuritë rreth gjësë të cilën mundohen ta kuptojnë.*

Problem tjetër paraqet edhe mungesa e renditjes së vlerave dhe prioriteteve, si dhe kompozimet mendore apo parimet kulturore dhe shkencore që nuk janë të unifikuara, ndërkohë që ata ngjarjet dhe gjërat i shikojnë pikërisht nëpërmjet tyre.

Nëse duam ta kuptojmë një çështje të ndërlikuar, atëherë patjetër duhet ta shkoqitim atë në sa më shumë pjesë që të jetë e mundur, ngase kështu mund të arrijmë ta kuptojmë më thellësisht. P.sh. nëse duam ta kuptojmë dukurinë e varfërisë, së pari duhet të definojmë se çfarë nënkuptojmë me të, pastaj ta kufizojmë atë në kohë dhe vend, për të vazhduar më pas me hulumtimin e rrënjëve të kësaj dukurie dhe shkaqeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, organet përgjegjëse për ekzistimin e saj, historinë e vendit në të cilin është përhapur kjo dukuri, gjeografinë dhe burimet ekonomike të atij vendi, traditat dhe zakonet e tij, natyrën e sistemit politik dhe ndikimin e vlerave në udhëzimin e mirëfilltë të njerëzve, sundimin e ligjit etj.”⁷

Të rinjtë ndërmjet entuziazmit dhe ekstremizmit

Paraqitjen e ekstremistëve dhe radikalëve në radhët e të rinjve muslimanë, të cilët thërrasin në rikthimin e krenarisë islame nëpërmjet ngritjes së flamurit të xhihadit dhe kryengritjes kundër liderëve dhe pushtetarëve, mendimtarët dhe analistët e shohin si problem të disfatës shpirtërore dhe krizës intelektuale tek muslimanët, rënies ekonomike dhe varfërisë ekstreme që ka goditur vendet islame, përçarjen në parti dhe grupime politike, sikurse që e shohin edhe si reagim ndaj shtypjes së muslimanëve, si përgjigje ndaj arrogancës dhe dhunës amerikane në Lindjen e Mesme dhe përkrahjes pa rezervë të saj për Izraelin, përkitazi me çështjen palestineze por edhe me muslimanët në tërësi.

Ky është shkaku që i shtyri këta të rinj radikalë dhe të mashtruar që të ndër marrin veprime të dhunshme dhe kriminale kundër njerëzve të pafajshëm, përfshirë këtu edhe fëmijë, gra dhe pleq, duke shkatërruar ndërtesa shtetërore, duke minuar ndërtesa kolektive dhe ura, duke vrarë jomuslimanë që kanë lidhje me shtetin, si dhe duke përhapur panik dhe frikë tek qytetarët.

Sa i përket xhihadit islam apo rezistencës fetare kundër okupatorit në Irak, pjesë e saj kanë qenë shumë profesorë universitarë dhe ekspertë të fushave

⁷ Bekkar, Abdul Kerim: *Asruna ve-l-ajshu fi zemanihî-s-sa’b*, f. 21-23.

islame në Arabinë Saudite. Ai është kundërshtuar nga një pjesë e dijetarëve, një prej të cilëve është Shejhu Abdul Muhsin el-Ubejkan, i cili e ka emërtuar atë: Xihadi i mbrojtjes. Por qëllimi i mirë a e justifikon mjetin e gabuar?!

Këta të rinj e kanë gabuar rrugën dhe e kanë humbur atë pa e vërejtur fare. Aktualitetin duhet ta lexojmë ndryshe, ndërsa qëndrimi ynë fetar duhet të jetë shumë i matur. *'Gabimi në perceptimin fetar të çfarëdo gjëje qëndron në tri shkaqe:*

- *në kuptimin e gabuar të teksteve fetare,*
- *në kuptimin e gabuar të ngjarjes a aktualitetit, trajtimi i të cilit synohet të bëhet me tekst fetar, dhe*
- *gabimi në përzgjedhjen e tekstit fetar adekuat për rastin apo aktualitetin.*

Muslimanët duhet t'i vënë interesat e domosdoshme para çdo gjëje tjetër, duke i dhënë përparësi çdoherë asaj që është më e rëndësishmja...⁸

Me këto sjellje të ngutshme ata i kanë bërë dëm më së shumti Islamit, pasi që kanë injoruar rolin dhe rëndësinë e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja, organ islam ky që i përfshin të gjithë, edhe pushtetarët, sikurse që kanë harruar porosinë e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] për t'i respektuar udhëheqësit përderisa ata janë muslimanë, madje edhe nëse na bëjnë padrejtësi. Imam Muslimi transmeton thënie të Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] përkitazi me këtë çështje, si:

Dëgjimi dhe nënshtrimi (ndaj urdhrave të prijësve janë obligim) për muslimanin, pavarësisht se i pëlqejnë këto apo jo, përderisa në to nuk ka urdhër për mëkat, ndryshe nuk ka dëgjim dhe as nënshtrim!"

Prijësin duhet ta dëgjosh dhe respektosh, edhe nëse të rreh dhe ta merr pasurinë. Dëgjoje dhe respektoje!"

⁸ Abdullah, Naxhah Ibrahim: Tefxhiratu-rr-Rrijad – el ahkam vel athar.

Do ta respektosh në vështirësi e lehtësi, në disponim e i detyruar, e madje edhe nëse favorizohet dikush ndaj teje...”

Imazhet e radikalëve dhe ekstremistëve

Karakteristikat më të theksuara të ekstremistëve janë:

- 1) Fanatizmi. Nuk i pranojnë mendimet e të tjerëve, sidomos në gjërat që mund të komentohen edhe ndryshe, e që ata i komentojnë si të formës së prerë. Nuk i dëgjojnë argumentet e të tjerëve, nuk mendojnë për to dhe as që bëjnë krahasime. Ata i lejojnë vetes të flasin për gjëra shumë të komplikuar e të ndërlikuar, ndërkohë që nuk kanë fare dituri. Nuk përtojnë aspak që t'i gjykojnë tjerët si risimtarë, hipokritë e besa edhe si jobesimtarë. Konsideroj se ky lloj terrorizmi ideor është shumë më i rrezikshëm se terrorizmi vdekjeprurës.
- 2) Ngarkimi i njerëzve me atë që Allahu nuk i ka ngarkuar. Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] ka thënë: *“Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos irritoni...”*, kështu që një muslimani nuk i lejohet ta ngarkojë xhematin me gjëra të vështira dhe të papërballueshme. Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] kur falej vetëm, e zgjaste namazin, ndërsa kur falej me xhemat, e shkurtonte. Ai e pati qortuar Muadhin për shkak se ia zgjaste namazin xhematit. (Buhariu) Këta i llogarisin nafilet sikur të ishin farze dhe gjërat e urryera (mekruhate) sikur të ishin harame.
- 3) Radikalizmi në shpërputhje me vendin, kohën dhe njerëzit. Ata shfaqen me kritere të ashpra ndaj njerëzve që ndoshta rishtazi kanë hyrë në Islam apo tash sa i janë kthyer fesë pas pendimit nga mëkatet apo edhe jetojnë në vende joislame, me të cilët do të duhej shfaqur një metodologji më lehtësuese për shkak të kushteve dhe rrethanave. Në fakt, metodologjia parasheh që me ta të fokusohemi në gjëra të përgjithshme, ashtu siç i tha Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] Muadhrit kur e dërgoi në Jemen: *“Je duke shkuar tek një popull i krishterë, andaj gjëja e parë që do t'i thërrasësh le të jetë dëshmia se askush*

nuk meriton të adhurohet përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij..." Fatkeqësisht, sot mund të hasësh të atillë që diskutojnë për pantallonat dhe kravatat e muslimanëve perëndimorë, ndërsa harrojnë të diskutojnë për gjëra shumë shqetësuese, siç është mungesa e besimit të vërtetë, dhënia pas dukurive negative etj.

- 4) Vrazhdësia në kumtimin e daves, gjë që është në kundërshtim të plotë me ajetet kur'anore dhe këshillat pejgamberike. Allahu ka thënë:

Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit." (en-Nahl: 125)

Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falua atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që mbështeten." (Ali Imran: 159)

- 5) Mendimet e këqija për njerëzit. Ata kanë si parim që të dyshojnë tek njerëzit dhe t'i akuzojnë ata, ndërkohë që ligjet thonë se *'i akuzuari është i pastër përderisa të mos vërtetohet me fakte faji i tij.'* Ata nuk ngurrojnë fare të të akuzojnë për shkakun më të vogël dhe as që lodhen të gjejnë ndonjë arsye. Përkundrazi, ata janë në gjurmim të të metave tona. Nëse nuk përfill ndonjë sunnet, si p.sh. nuk bart shkop apo nuk ha në tokë, të akuzojnë se ti nuk e do sunnetin dhe rrjedhimisht as të Dërguarin e Allahut. Çak i tyre nuk janë vetëm të gjallët. Ata sulmojnë edhe të vdekurit, sikur janë imamët e njohur të katër medhhebeve etj. Sikur t'i ktheheshin Kur'anit dhe Sunnetit ata do ta gjenin vetë udhëzimin. Allahu ka thënë:

O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat, mos hulumtoni për zbulimin e të metave të

njëri-tjetrit dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është mëshirues, Ai e pranon shumë pendimin.” (el-Huxhurat: 12)

6) Ndërsa Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

Kini kujdes supozimet, ngase ato janë të folurit më i rremë (i mundshëm).”

7) Vështrimi imagjinar mbi shoqërinë se si – në mënyrë përrallore – duhet të jetë. Ata mendojnë se shoqëria islame duhet të jetë e tipit engjëllor dhe se vetëm me këtë karakter mund të jetë shoqëri islame, ndryshe është shoqëri injorante. Ky është ekstremizëm në perceptim dhe ikje nga realiteti. Çdo njeri gabon dhe gabimet janë pjesë e çdo shoqërie. Madje as shekujt më të mirë të njerëzimit nuk kanë qenë pa mëkate.

8) *Tekfiri* apo shpallja e njerëzve si renegatë. Ata i shpallin njerëzit për të pafe, si dhe lejojnë vrasjen dhe marrjen e pasurive të tyre. Kështu patën vepruar më parë havarixhët, të cilët edhe pse i praktikonin shumë ritualet fetare, humbën, jo për shkak të prishjes së ndërgjegjes, por nga prishja e kufrit – jobesimit. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] i përshkroi ata si njerëz që po të gjendesh pranë tyre, i merr për shumë të devotshëm, aq sa i injoron lutjet apo adhurimin tënd karshi adhurimit të tyre, por ata dalin prej Islamit ashtu siç del shigjeta nga harku i saj. Ata e lexojnë Kur’anin, por leximi i tyre nuk e kalon dot fytin e tyre. Ata i luftojnë muslimanët, ndërsa i lënë të lirë idhujtarët. Havarixhët, pas një shkëputjeje goxha të madhe, tani kanë pasues. Lëvizja *Tekfir ve Hixhreh* është ajo e cila tani i shpall muslimanët të dalë nga feja për shkak të rënies në një mëkat, nëse nuk pendohet. Kështu veprojnë edhe me liderët, dijetarët dhe popullin. Ai që iu bashkohet radhëve të tyre një herë, ndërsa më pas, për shkaqe të caktuara, e braktis atë grup, shpallet i pafe dhe lejohet vrasja e tij.

Shkaqet dhe motivet e ekstremizmit

Analistët dhe mendimtarët kanë llogaritur se shkaqe të mundshme të ekstremizmit janë:

- 1) Mungesa e njohurive fetare që do t'u mundësonte atyre depërtimin në fshehtësitë dhe sekretet e objektivave të fesë.
- 2) Komentimi sipërfaqësor i teksteve fetare, pa i analizuar fare shkaqet dhe urtësitë që qëndrojnë prapa ligjësimit të tyre.
- 3) Marrja me detaje dhe probleme sekondare, në dëm të çështjeve madhore të ummetit.
- 4) Ndalimi i gjërave vend e pavend dhe kritikave të tepërta dhe jo konstruktive, duke iu shmangur kështu metodologjisë selefiste që nuk i ndalon gjëra pa qenë ndalesa e prerë.
- 5) Marrja me tekstet jo të qarta dhe braktisja e atyre që janë të qarta dhe që janë për nivelin e tyre intelektual.
- 6) Mosmarrja e edukimit tek dijetarët dhe profesorët e dëshmuar.
- 7) Mungesa e dijes dhe njohurive për aktualitetin, jetën, historinë dhe ligjet natyrore të Allahut.
- 8) Vizioni i turbullt përkitazi me xhihadit, qëndrimin ndaj jomuslimanëve, ndalimin e së keqes me dorë, kryengritjen ndaj liderëve etj.

E lusim Allahun e Madhëruar të na mundësojë kuptimin e fesë së Tij ashtu siç e bën Atë të lumtur dhe të kënaqur!

MËSIMET DHE URTËSI NGA STRATEGJIA E BASHKËVEPRIMIT ME TË TJERËT

Allahu i Madhëruar në Kur'anin Famëlartë thotë:

Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun.” (el-Ahzabë: 21)

Vërtet, i Dërguari i Allahut [*alejhis salatu ves selam*] mbetet për ne prijës dhe shëmbëlltyrë, prijës dhe model për udhëzimin e njerëzve në rrugën e mbarë. Allahu e dërgoi mëshirë për të gjitha botët, ndërsa ne, sot, në këtë kohë të vështirë, kemi nevojë më shumë se kurrë për të dhe mësimet e tij për t'i zgjidhur problemet e shumta shoqërore që kemi. Nga këndvështrimi i zhvillimeve denigruese dhe çoroditëse të shoqërisë bashkëkohore, mund të konstatojmë se fati i njerëzimit është i lidhur me dy gjëra të rëndësishme:

1. raportet e tij me Krijuesin, dhe
2. raportet me njerëzit.

Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ofroi një model të përkryer për të dy këto raporte. Sa i përket aspektit shpirtëror, Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] kishte arritur majat e adhurimit, devotshmërisë, përruljes dhe ruajtjes nga ndalesat. Po kështu, edhe në raportet me njerëzit, ai na solli shembullin më të mirë të mundshëm. Dhe ja, biografia e tij është përplot të vërteta që e provojnë këtë. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] merrej si shembull për trajtimin e *tjetrit*, për mëshirën e tij ndaj të dobët, për mirësjelljen ndaj robit, për butësinë ndaj të gjithëve, pavarësisht besimit që kishin. Rrjedhimisht, edhe besimtari, si pasues i Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], e ka obligim që të mishërohet me këto parime, me këtë sjellje brilante dhe me këtë edukatë të besimit dhe fesë së tij.

Konsideroj se për ta kuptuar qëndrimin e palës islame për këtë problematikë duhet t'i referohemi gjithsesi thënieve të Pejgamberit

Muhammed [*alejhis salatu ves selam*] dhe rasteve të ndryshme nga jeta e tij. Kështu:

Kush është tjetri dhe cili është qëndrimi i të Dërguarit [*alejhis salatu ves selam*] karshi tij?

Kohët e fundit na ka rënë shumë shpesh ta dëgjojmë fjalën ‘tjetri’ dhe jo rrallë kjo fjalë përdoret edhe në shkrime të ndryshme. Por cilat janë shkaqet e përhapjes dhe përdorimit të shumtë të kësaj fjale? Disa dijetarë thonë: Çdonjëri prej nesh është ‘tjetri’ për tjetrin; gruaja është ‘tjetri’, babai është ‘tjetri’, biri është ‘tjetri’, miku është ‘tjetri’, armiku është ‘tjetri’, rivali në lojë është ‘tjetri’, muslimani është ‘tjetri’, çifuti është ‘tjetri’, i krishteri është ‘tjetri.’ Por, ky term sot ka një përdorim tjetër. Ai nënkupton dallimin e Perëndimit apo jomuslimanëve nga çifutët dhe të krishterët, dhe kjo për shkak të përkeqësimit të raporteve politike, diplomatike dhe fetare, si dhe për shkak të së kaluarës së përgjakur ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve.

Ndërsa ne, për çështjen në fjalë, do të theksojmë qëndrimin e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], nëpërmjet prezantimit të disa prej aspekteve të jetës së tij, si:

1. Respektimi i qenies njerëzore

Pejgamberi Muhammed [*alejhis salatu ves selam*] na mëson se njerëzit, me gjithë dallimet që mund të kenë në gjuhë, ngjyrë, racë dhe fe, prapë mund të gjejnë një element të përbashkët dhe mund të strehohen nën një ombrellë e vetme, nëse ata pajtojnë për ta respektuar njërin-tjetrin. Allahu ka thënë, pa specifikuar:

Ne vërtet i nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësua të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësua ata (i lartësua) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.” (el-Isra, 70)

Allahu e nderoi llojin njerëzor duke i dhuruar mendje, të kuptuar dhe intelekt. Po ashtu, Ai u dërgoi peygamberë, u shpalli libra, si dhe ua la në dispozicion tokën që ta shfrytëzojnë racionalisht për nevojat e tyre. Në këto begati kanë hise të gjithë njerëzit dhe ky nderim u përket të gjithëve. Për këtë dëshmon edhe praktika e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]. Imam Buhariu transmeton në Sahihun e tij se Peygamberi [*alejhis salatu ves selam*] ishte ngritur në këmbë kur pranë tij kishte kaluar kufoma e një çifuti. Shokët e kishin pyetur të habitur se përse ishte ngritur në këmbë për atë, që kishte vdekur madje si jomusliman?! Peygamberi [*alejhis salatu ves selam*] ishte përgjigjur:

“Po, a nuk është (të paktën) qenie njerëzore (që meriton respekt)?!”

Ky hadith, padyshim, dëshmon praktikisht parimin kur'anor për nderimin e të gjithë njerëzimit, pa dallim.

2. Shtrirja e urave të besnikërisë

Peygamberi [*alejhis salatu ves selam*] ishte shumë këmbëngulës për mbajtjen dhe forcimin e lidhjeve me *tjetrin*, si dhe për ngjalljen e ndjenjave pozitive karshi njëri-tjetrit. Këtë të vërtetë mund ta konstatojmë edhe nga një vështrim, qoftë edhe kalimthi, i biografisë së tij të ndritur. Kur u nis për hixhret (migrim), Peygamberi [*alejhis salatu ves selam*] mori për udhërrëfyes një idhujtar, emri i të cilit ishte Abdullah Ibn Urejkit el-Lejthi. Siç e dini, udhëtimi ishte i vështirë sa s'bëhej, për shkak se kurejshët kishin ofruar shuma të mëdha parash për ata që do t'ua kthenin Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] dhe Ebu Bekrin sërish në Medinë. Por, metodologjia e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], për të qenë i hapur ndaj tjetrit dhe për të themeluar raporte të ndërsjella dhe besnikëri reciproke, e shtyu që t'i bartte këto rreziqe dhe ta merrte atë për udhërrëfyes. Sigurisht se kjo nuk është dëshmia e vetme. Ka dhe tregime të tjera, madje edhe më interesante. Kurejshët, para hixhretit, i bënë zullum Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] dhe muslimanëve, por megjithatë gjërat e çmuara që kishin, për shkak të besnikërisë, i linin tek Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*], i cili,

kuptohet, si një lider fetar që synonte ndërtimin e raporteve të ndërsjella me njerëzit dhe përfitimin e zemrave të tyre, i pranonte me kënaqësi.

Argument tjetër, që provon se vërtet Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] dispononte një karakteristikë të tillë, është edhe hadithi, që e transmeton Imam Buhariu në Sahihun e tij nga sahabiu i nderuar, Enes Ibn Maliku, i cili rrëfen për një djalosh çifut, që i shërbente Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]. Ai ishte i sëmurë për vdekje, prandaj Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] e vizitoi atë. Kur e pa në atë gjendje, ai u afrua te koka e tij dhe i tha: Pranoje Islamin! Djaloshi shikoi babanë për të marrë mendimin e tij, ndërsa ai i bëri me kokë një shenjë pohimi dhe i tha: Respektoje babanë e Kasimit!⁹ Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] doli prej tij duke thënë: *Falënderimi i takon Allahut që nëpërmjet meje e shpëtoi nga zjarri!*"

Sot shumë muslimanë mund të çuditen apo edhe të jenë skeptikë karshi kësaj ndodhie, por kjo ka ndodhur me të vërtetë. Hapja e shoqërisë islame ndaj pakicave joislame dhe transparenca me ta ka luajtur rol vendimtar në përqafimin e Islamit nga ana e tyre. Ndërsa sot, imazhet e diferencimit dhe distancimit ndërmjet muslimanëve dhe të tjerëve, që mund t'i hasim në disa vende, sigurisht se nuk burojnë nga këshillat dhe edukata rrënjësore fetare. Ato mbase janë produkt i ndjenjave shpirtërore dhe traditave shoqërore që janë ndërtuar mbi bazën e frikës dhe dyshimit. Islami na ka lejuar që ta vizitojmë jomuslimanin që jeton në shtetin islam, ta këshillojmë dhe t'i ndalim në ndihmë a mbrojtje atij. Ka dallim të madh ndërmjet jomuslimanit që jeton në shtetin islam si paqësor (ka besë) dhe jomuslimanit që lufton kundër Islamit dhe muslimanëve. Një argument që dëshmon për ekzistimin e raporteve tregtare të Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] me jomuslimanët është hadithi për çifutët e Hajberit, të cilin e ka shënuar Imam Buhariu në Sahihun e tij. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] iu kishte atyre dhënë toka dhe ara për t'i punuar dhe kishte caktuar që 50% të fitimit ta mbanin për vete. Po kështu është vërtetuar se Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] e kishte lënë parzmoren e tij tek një çifut për

⁹ Llagap i Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*].

tridhjetë *saë*¹⁰ elb. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ia kishte dhënë një rrobë Omerit [*Allahu qoftë i kënaqur me të*], ndërsa ai ia kishte dërguar atë një vëllai të tij në Mekë, që atëbotë ende nuk e kishte pranuar Islamin. Ky shkëmbim i ndërsjellë dhuratash bart në vete domethënien e atdhetarizmit apo jetesës në një vend dhe atdhe të përbashkët. Patjetër se këto veprime pejgamberike përputhen me ajetin kur'anor:

All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë." (el-Mumtehine, 8)

Kjo *mirësi*, siç sqarojnë disa dijetarë, përfshin butësinë ndaj të dobëtëve të tyre, përmbushjen e nevojave të të varfërve të tyre, ushqimin e të uriturve dhe veshjen e të varfërve të tyre, si dhe butësinë në fjalë, jo nga frika dhe nënshtrimi, por nga mëshira.

3. Kuptimi i tjetrit

Është normale që në mes të dy palëve, muslimanëve dhe të tjerëve, të ketë kundërthënie dhe mospajtime, për të mos thënë se kjo është e pashmangshme, por Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] na ka mësuar se si t'i kuptojmë apo perceptojmë dallimet ndërmjet nesh, duke u fokusuar në thelb të çështjeve e jo në sfond të tyre. Ai që thellohet në metodologjinë e sjelljes së Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] me jomuslimanët dhe hipokritët sigurisht se ka për të hasur në domethënie të tilla. Si shembull mund të marrim Marrëveshjen e Hudejbijes, në të cilën shfaqet figura e një jomuslimani negociues, Suhejl Ibn Amrit, i cili nuk pajtohet me disa pika të marrëveshjes, që në fakt nuk janë pika por vetëm shprehje. Më konkretisht, kur Aliu [*Allahu qoftë i kënaqur me të*] shkroi në deklaratën e Marrëveshjes: *Bismil-lahi'rr Rrahmani'rr Rrahim!* (Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!), Suhejli i refuzoi këto fjalë hyrëse, për shkak se – kinse –

¹⁰ *Saë* është masë matëse që është baras me: 2.035 kg. Shih: <http://www.saaid.net/bahoth/80.htm> (shën. i përkth.).

nuk e dinte se kush ishte Rrahmani¹¹ dhe në vend të kësaj, propozoi një formë, jo tradicionale islame por që nuk binte ndesh me të, e cila njëherësh iu përshtatej edhe atyre (si palë e marrëveshjes): *Bismike Allahumme!* (Me emrin Tënd, o Zoti ynë!) Suhejli, po ashtu, nuk u pajtua që Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] të figuronte në marrëveshje si i Dërguar i Zotit, me arsyetimin se nuk e njihte për të tillë, andaj kërkoi të shkruhej: Muhammedi, i biri i Abdullahut! Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] e pranoi një gjë të tillë, duke thënë se ‘*Unë jam i Dërguar i Zotit, edhe nëse ju më përgënjeshtroi!*’ Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] e urdhëroi Aliun që ta fshinte këtë të fundit, por Aliu refuzoi, prandaj ai e fshiu me dorën e vet.

Ky rast dhe kjo marrëveshje duhet të jenë mësim për muslimanët, e në veçanti për thirrësit fetarë, që të kenë aftësinë për të bashkëvepruar dhe për t’i kuptuar të tjerët në raste të caktuara, duke krijuar kështu mundësinë e mbajtjes së lidhjeve me të tjerët. Fokusi ynë duhet të jetë tek thelbi dhe esenca e gjërave, e jo tek forma dhe sfondi i tyre. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] patjetër se ishte i bindur në fitoren e Allahut dhe në premtimin e Tij për të hyrë në Mekë¹², kështu që nuk brengosej shumë pse në disa gjëra të thjeshta lëshonte pe, edhe pse ato dukeshin si të mëdha, por që gjatë shtjellimit të detajuar kuptohet se nuk ishin të tilla. Allahu e di më së miri!

4. Maturia dhe largimi nga euforia në gjykimin për të tjerët

Ngutja është një cilësi e mbjellë në shpirtrat e njerëzve. Njerëzit e kanë zakon që ta gjykojnë si të marrë apo të humbur atë me të cilin nuk pajtohen. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] e porosit Ummetin e tij që të ketë kujdes e të mos nxitohet në paragjykime apo vendime përfundimtare për të tjerët, sidomos kur janë në pyetje çifutët dhe të krishterët. Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë: “*Kur t’iu flasin ithtarët e librit, ju as mos i pohoni dhe as mos i përgënjeshtroi, por thoni: Kemi besuar Allahun, librat dhe të Dërguarit e Tij...!*” Kjo, për shkak se ata kanë trashëguar nga pejgamberët e tyre fjalë dhe thënie që mund të jenë të vërteta, por edhe të

¹¹ “Rahman” është një prej emrave të bukur të Allahut.

¹² Marrëveshja në fjalë ka të bëjë me hyrjen e muslimanëve në Mekke.

shtrembra, andaj, përderisa ne nuk kemi nevojë për to ngase kemi Kur'anin dhe fjalët e të Dërguarit tonë [*alejhis salatu ves selam*], atëherë bëjmë mirë që të kemi qëndrim neutral, as të mos i pohojmë por as të mos i përgënjeshtrojmë.

5. Përfitimi nga tjetri

Ndodh që *tjetri* të ketë zgjidhje për problemet tona, apo të ketë përvojë dhe eksperiencë, të cilat na hyjnë në punë dhe na nevojiten. Ajo që dëshmon për këtë është në fakt vetë thënia e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] e regjistruar në Sahihun e Imam Muslimit, e cila ka të bëjë me marrëdhëniet intime apo me lënien shtatzënë të gruas gjatë kohës që ajo e ka foshnjën në gji. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*], nga frika se gruaja mund të dëmtohej, kishte dashur ta ndalonte një gjë të tillë, por kur kishte mësuar se romakët dhe persianët e bënë një gjë të tillë ndërsa gruaja dhe shëndeti i saj nuk dëmtohej, atëherë ai nuk kishte ndërmarrë asgjë.

Pra, Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] kishte përfituar nga eksperiencia e persianëve dhe romakëve për këtë çështje. Po kështu kishin vepruar edhe shokët e tij më pas, siç ishte rasti i Omerit [*Allahu qoftë i kënaqur me të*], i cili përvetësoi sistemin administrativ joarab për arkën e shtetit.

6. Përmbushja e premtimeve

Përmbushja e premtimeve është një prej tipareve më të theksuara të moralit pejgamberik në raportet dhe trajtimin e *tjetrit* armiqësor dhe luftëtar. Imam Muslimi [*Allahu e mëshiroftë*] transmeton, në Sahihun e tij, hadithin e Hudhejfe Ibn Jemanit [*Allahu qoftë i kënaqur me të*], i cili rrëfen: “Unë dhe Ebu Usajli nuk mundëm të marrim pjesë në Betejën e Bedrit sepse, pasi dolëm për luftë, na zunë mosbesimtarët kurejshitë. -Ju po shkoni t’i bashkëngjiteni Muhammedit? - na thanë. -Jo, ne jemi nisur për në Medinë (e jo për betejë) - iu thamë. Ndërsa ata morën besën e Allahut prej nesh se do të shkonim në Medinë dhe nuk do të luftonim përkrah Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]. Ne shkuam tek i Dërguari i Allahut [*alejhis salatu ves selam*] dhe e njoftuam për rastin tonë, ndërsa ai na tha: *Shkoni! Ne e*

përmbushim premtimin ndaj tyre, ndërsa kërkojmë ndihmën e Allahut kundër tyre!"

Një tregim tjetër që flet për këtë është edhe Marrëveshja e Hudebijes, që e përmendëm më lart, një prej pikave të së cilës ishte edhe kjo: Kushdo prej kurejshëve që shkon te Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*], ai duhet t'ua kthejë atyre, por jo anasjelltas (pra, kurejshët nuk janë të detyruar që t'i kthejnë ata që dezertojnë nga radhët e muslimanëve dhe shkojnë në Mekë.)

7. Toleranca dhe falja

Këtë e dëshmon më së miri rasti i shkuarjes së Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] në Taif, ku ai iu ekspozua një dhune nga fëmijët dhe të marrët e atij vendi. Xhibrili [*alejhis selam*], bashkë me melekun e kodrave, shkoi te Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] dhe i tha se po të donte ai do t'i shkulte kodrat dhe do t'ua hidhte sipër. Por Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] nuk e dëshiroi këtë gjë. Ai shpresonte se Allahu do të bënte që nga pasardhësit e tyre të dilnin njerëz që do ta adhuronin Allahun dhe nuk do t'i përshkruanin Atij shok.

Edhe çlirimi i Mekës ishte një dëshmi e moralit hyjnor me të cilin që edukuar Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*]. Pejgamberi, [*alejhis salatu ves selam*], siç transmeton Enesi [*Allahu qoftë i kënaqur me të*], nuk i kishte rënë kurrë me shuplakë askujt, qoftë grua, fëmijë apo shërbëtor, përveç nëse kishte qenë në luftë, si dhe nuk ishte hakmarrë për veten, por vetëm për hir të Allahut...

Kjo është gjëja që i mungon botës mbarë dhe kjo është ajo gjëja e humbur e ummetit islam, të cilën ai duhet ta gjejë sa më parë!

Qëndrimi ynë ndaj çifutëve dhe të krishterëve

Kur'ani Famëlartë na ka treguar se qëndrimi i ithtarëve të librit karshi muslimanëve nuk është sikurse qëndrimi i muslimanëve karshi tyre.

Gjithqysh ti do të vëresh se jehuditë dhe ata që i përshkruan Zotit shok (idhujtarët) janë njerëzit me armiqtësi të fortë kundër besimtarëve (kundër muslimanëve). Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë: "Ne jemi nesara-krishterë". Këtë ngase prej tyre (të krishterëve) ka dijetarë (ulema) dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneçë." (el-Maide, 82)

Dallimi apo mospajtimi nuk është për shkak të parimeve tona fetare, por për shkak të politikës armiqësore të tyre ndaj nesh. Armiqtësia e çifutëve ndaj nesh nuk është për shkak të besimit, por për shkak të urrejtjes dhe mërisë së tyre. Qëndrimet tona karshi tyre janë parimore. Ato nuk ndërrojnë veçse atëherë kur ata shndërrohen në armiq. Konsideroj se raportet e ftohta ndërmjet nesh nuk janë për shkak të besimit, por për shkak të mungesës së trajtimit dhe qëndrimeve. Shpresojmë që Perëndimi dhe Amerika ta kuptojnë këtë botëkuptim të trajtimit dhe të punojnë për përmirësimin e raporteve me Islamin dhe muslimanët. Ata duhet t'i braktisin fyerjet dhe ofendimet, duhet t'i ndërrojnë politikat diskriminuese dhe duhet të jenë më korrekt me ne. Për të qenë sa më korrekt, them se edhe pse duhet të bëjmë një dallim ndërmjet politikave të qeverive dhe popujve të tyre, megjithatë duhet thënë se edhe këta të fundit kanë një ndikim jashtëzakonisht të madh në ndezjen e zjarrit të krizave dhe në prishjen e raporteve.

Për fund fare, përderisa motoja e misionit të Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] ishte mëshira dhe përhapja e saj, atëherë neve na mbetet që të reflektojmë mëshirë, paqe, urtësi, transparencë, mirësi dhe kuptim ndaj tjetrit...Duhet që të bashkëveprojmë me mirësi me të tjerët në mënyrë që t'i udhëzojmë në dritën e vërtetë, në të cilën ne jetojmë:

O ithtarë të librit, juve ju erdhi i dërguari Jonë që ju sqaron shumë nga ajo që fshihnit prej librit, e për shumë nuk ju jep sqarime. Juve ju erdhi nga All-llahu dritë dhe libër i qartë." (el-Maide, 15)

MALAJZIA SI MODEL PËR ARSIMIMIN E DËSHIRUAR NË KOHËN BASHKËKOHORE

Allahu i Madhëruar thotë:

...All-llahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. All-llahu është i njohur mirë me atë që punoni.” (el-Muxhadele, 11)

... thuaj: "Zoti im, më shto dituri!" (TaHa, 114)

E Sulejmanit Ne ia mësuam atë (përgjigjen e saktë), po secilit (prej tyre) u patëm dhënë urtësi e dije...” (el-Enbija, 79)

...në fund asaj i vjen era misk! E për shpërblim të tillë le të garojnë ata që lakmojnë të mirën.” (el-Mutaffifine, 26)

O Zot i Gjithëdijshtëm! Të lusim për dituri, mirësia e së cilës na shërben në këtë botë dhe në botën tjetër, sikurse që të lusim të na bekosh për sinqeritet dhe vepra të mira! Të lusim të mos na privosh nga përfitimi i përvojave të suksesshme të të tjerëve në mësimdhënie, ngase, vërtet, Ti i dëgjon lutjet tona, je afër nesh me mëshirën Tënde dhe na përgjigjesh!

Malajzia është një shtet multi-fetar, multi-kulturor dhe multi-etnik, që shtrihet në Azinë Juglindore.

Kishte qenë caktim i Allahut që autori i këtyre rreshtave t'i kryejë studimet postdiplomike, magistraturën dhe doktoratën dhe të kalojë një pjesë bukur të gjatë të jetës pikërisht në këtë vend, në mesin e këtij populli musliman të civilizuar, që krahas tradicionales kultivoi edhe modernen, krahas parimeve fundamentale të Islamit përvetësoi edhe risitë e jetës së avancuar, duke u bërë kështu një model i shkëlqyer i Islamit dhe muslimanëve në të gjitha fushat dhe nivelet arsimore, ekonomike dhe industriale.

Malajzia aspironte për përparim popullor, kombëtar, industrial, teknologjik, ekonomik dhe arsimor, ideale këto për të cilat u përpoq shumë derisa edhe realizoi qëllimin, duke u çliruar nga kolonizatori anglez. Qysh

në ditën e shpalljes së pavarësisë, Malajzia u zotua për reforma në sistemin arsimor të trashëguar nga pushtuesi anglez.

Kjo nismë u përkrah nga të gjitha forcat politike në vend, në bazë të unitetit kombëtar në të gjitha periudhat e arsimit, me shpresën se kjo do t'ia hapte shtigjet zhvillimit ekonomik e shoqëror.

Realizimi i këtyre reformave iu besua Ministrisë së Edukimit dhe Arsimit, e cila mori përgjegjësinë e mbjelljes së parimeve edukative në zemrat e të rinjve, duke startuar nga ideja e tyre kombëtare “Rukun Negara”, që nënkupton aspiratat e Malajzisë drejt unitetit, përparimit dhe zhvillimit.

Parimet e kësaj ideje kombëtare të edukimit malajzian mbështeten mbi këto bazat:

1. Besimi në Zot
2. Respektimi dhe besnikëria ndaj mbretit dhe shtetit
3. Zbatimi i kushtetutës dhe ligjit
4. Sundimi i ligjit
5. Mirësjellja dhe morali i mirë

Ndërsa sa i përket objektivave të kësaj ideje kombëtare, ato mund të përmbliidhen si vijon:

1. Krijimi i një shoqërie multi-etnike dhe fetare
2. Krijimi i një shoqërie demokratike, nëpërmjet një parlamenti të votuar ligjërisht.
3. Krijimi i një shoqërie të drejtë, të paanshme dhe me të drejta të barabarta.
4. Krijimi i një shoqërie liberale me zakone, kultura dhe civilizime të ndryshme.
5. Krijimi i një shoqërie që synon shkencën dhe teknologjinë.

Në fillim të vitit 1996, Ministria e Edukimit në Malajzi filloi hulumtimet rreth mundësisë së krijimit të shkollave të këtij lloji në vend. Në fund të po atij viti, koncepti i kësaj ideje u zgjerua për të vënë hapin e parë në korrik të

vitit vijues (1997), ku u prezantuan studime, hulumtime, mendime dhe shkrime të ndryshme, nga ekspertë të edukimit, rreth zbatimit të kësaj ideje dhe nxjerrjen e saj nga margjinat e një teorie në rrafshin praktik.

Më 28 korrik 1999, Telekom-i i Malajzisë nënshkroi një marrëveshje me shtetin për ekzekutimin e këtij projekti dhe zbatimin e tij në 90 shkolla malazise, anekënd vendit. Kompletimi i këtij projekti ishte planifikuar të bëhej nga fundi i vitit 2002.

Këto 90 shkolla fatlume do të merrnin përsipër përgatitjen e plan-programeve shkollore për shkollat e tjera të këtij tipi që do të hapeshin në vitet në vijim. Në vitin 2010, të dhjetëmijë shkollat e mesme dhe fillore, që i potencuam më herët, do të ngriheshin në shkallën dhe nivelin e këtyre shkollave me sistem të avancuar.

Në korrik të vitit 2002, shkolla e para malaziane me sistem të avancuar, ndjekëse e kompanisë së sipërpërmendur, nënshkroi një kontratë tregtare me qeverinë malaziane për t'ia lejuar zyrtarisht asaj tregtinë ndërkombëtare me idetë, plan-programet dhe parimet e kësaj shkolle.

Objektivat e shkollave të avancuara (Smart Schools):

- Stimulimi për zhvillimin e përgjithshëm të personalitetit (ideor, fizik, emocional, shpirtëror).
- Dhënia e mundësisë qytetarëve, meshkuj e femra, që të zhvillojnë shkathtësitë e tyre.
- Krijimi i një fuqie punëtore, inteligjente dhe njohëse të teknologjisë bashkëkohore.
- Dhënia e së drejtës së arsimimit të gjithëve, pa asnjë përjashtim.
- Nevoja e participimit të familjes dhe shoqërisë në çuarjen përpara të proceseve arsimore.

Vizioni i shkollave të avancuara (Smart Schools)

Synimi i këtyre shkollave është që ta pajisin nxënësin me një përvojë efikase e cila do t'i shërbejë në jetë. Në vend që ai të bartë çantën e rëndë plot libra, ai do të bartë vetëm *Lap Top*-in personal. Sipas deklaratave të ish-Ministrit të Edukimit, Datuk Seri Najib Tun Razak, nxënësi do të ketë qasje në informacione të pafundme nëpërmjet kompjuterit të tij. Edhe provimet do të jenë pikërisht nëpërmjet kompjuterëve. Nëse ndodh që nxënësi të mungojë në shkollë për shkaqe shëndetësore, atëherë ai do të ketë mundësi ta përcjellë mësimin nëpërmjet *Lap Top*-it të tij.

Kështu, kjo ide u mirëprit nga të gjithë ngase ishte një projekt që do ta ndryshonte të ardhmen për të mirë. Nxënësi do të kishte mundësinë e marrjes së informacionit teknologjik në të gjitha fushat e arsimit, atë administrativ, ekonomik etj.

Filozofia malajziane fokusohet në krijimin e një gjenerate të baraspeshuar në aspektin ideor, shpirtëror, emocional dhe fizik, dhe të pajisur me njohuri teknologjike dhe industriale. Kjo shkollë dhe simotrat e saj aspirojnë që ta rrisin edhe nivelin e participimit të prindërve në zhvillimin e shkathtësive të bijve dhe bijave të tyre.

Në klasë, krahas librave dhe pajisjeve të tjera shkollore, do të jenë edhe programet e ndryshme kompjuterike në CD-ROM, me të gjitha pajisjet e nevojshme...

Kurse sa i përket mënyrës së ekzekutimit të këtij programi edukativ bashkëkohor, kjo kërkon sigurimin e kompjuterëve qendrorë, ku do të jetë një *database* me të dhënat e të gjithë mësuesve dhe nxënësve. Këta kompjuterë do të jenë të lidhur me Zyrën për Çështje Edukimi në Ministrinë e Edukimit dhe, rrjedhimisht, çdo nxënës do të ketë qasje në të për t'u pajisur me programe shkollore dhe me informacione të ndryshme nëpërmjet internetit. Kjo mundësi do të jetë gjithsesi në dispozicion edhe për mësuesit. Madje ata, krahas këtyre, do të kenë qasje edhe në dosjet e nxënësve. Meqë kjo punë është e rëndësishme, atëherë është paraparë

doemos caktimi i një koordinatori që do të mbikëqyrë punën e të gjitha mjeteve informative dhe teknologjike të këtyre shkollave.

Deri më tash (2009) janë trajnuar rreth 4800 mësues dhe profesorë, të cilët do të punojnë në këto shkolla. Ministria e Edukimit do të caktojë përgjegjës dhe koordinatorë për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e këtyre programeve bashkëkohore, kohë pas kohe.

Rezultati i pritur nga ky projekt grandioz pritet të jetë i madh, ngase do të përgatitë një gjeneratë e cila do të jetë e aftë për përdorimin e teknologjisë moderne.

Duke marrë parasysh koston e lartë të krijimit të këtyre shkollave, me kushtet dhe mjetet e përmendura më lart, qeveria malajziane kërkoi dhe stimuloi donacione vullnetare nga shkollat e tjera që kanë synim t'i bashkëngjiten karvanit të këtyre 90 shkollave të avancuara. Qeveria nxiti edhe kompanitë e mëdha që t'i kontribuojnë këtij ideali. P.sh. Shoqata Uniteti Kinezo-Malajzian ndau një shumë marramendëse parash për realizimin e këtij projekti arsimor të madh në 114 shkollat e saj kineze, anekënd Malajzisë. Një rrugë të tillë e ndoqi edhe MIMOS-i (Instituti Malajzian i Sistemeve Mikroelektronike) për 50 shkolla të zgjedhura malajziane.

DREJT NJË METODOLOGJIE KUR'ANORE MBI KRITIKËN

Kriteri për vlerësim objektiv dhe të balancuar është kërkesë islame, për të cilën ka aluduar Kur'ani, Sunneti dhe kompaktësia e Ummetit, si në të kaluarën, po kështu edhe në të tashmen. Ky kriter nënkupton që muslimani, gjatë vlerësimit dhe kritikës së tij, duhet të përmendë të mirat

dhe të këqijat, aspektet pozitive dhe ato negative të çështjes ndaj së cilës zhvillohet kritika.

Jo rrallë dëgjojmë dhe lexojmë kritika dekonstruktive, aspak objektive, që përkufizohen vetëm në përmendjen e dobësive dhe të metave, ashtu siç thotë poeti:

Por, syri i hidhërimit shfaq vetëm të metat.

Rëndom këto kritika lansohen kundër disa dijetarëve, mendimtarëve dhe përgjegjësve të organizatave qeveritare dhe edukativo-arsimore. Fatkeqësisht, kjo dukuri, që tashmë është bërë e përhapur, paraqet në fakt një ankth për të tashmen dhe të ardhmen e ummetit.

Për trajtimin e saj duhet vënë patjetër një limit që nuk duhet të kalohet dhe ajo duhet të shërohet sipas udhëzimeve kur'anore dhe pejgamberike, ngase konsideroj se kritikët dekonstruktivë janë larg Kur'anit dhe sunnetit.

Shkëndijë kur'anore përkitazi me metodologjinë kritikuese

Kur'ani Fisnik na solli shembullin më të mirë dhe kurrikulën më të përsosur për mënyrën e vlerësimit apo gjykimit të gjërave. Duke përmendur pyetjen e idhujtarëve drejtuar Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] për rakinë dhe bixhozin, Allahu i Madhëruar thotë:

Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: "Që të dyja janë mëkat i madh, e ka edhe dobi në to (të pakta) për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre. Të pyesin ty edhe se ç'do të japin. Thuaj: "Tepricën"! Kështu ua sqaron All-llahu juve argumentet ashtu që të mendoni (çka është mirë e çka është keq)." (el-Bekare, 219)

Nuk ka gjëra më të pavlera se rakia dhe bixhozi, por qëndrimi i Kur'anit karshi kësaj pyetjeje ishte për t'u lakmuar. Zoti e mësoi Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] që t'iu thotë pyetësve, që e parashtruan pyetjen, se në këto dy gjëra ka të këqija (mëkat), por ka edhe të mira. Pra, në to ka hajr,

por ka edhe sherr. Ka gjëra pozitive, por edhe negative, vetëm se për hir të së vërtetës, të këqijat janë më shumë se të mirat.

Ky është gjykim objektiv dhe kjo është metodologjia praktike më e balancuar dhe më transparente, të cilën duhet ta përvetësojmë për vlerësimin e çështjeve, por edhe të kontributit dhe punëve të të tjerëve, kushdo qofshin ata. Armiqësia ose mospërputhja e ideve dhe mendimeve nuk duhet kurrësi të na shtyjë në refuzim total apo në kritikë negative pa rezervë, sepse sado të këqija të jenë veprat e njeriut, ato nuk mund të jenë në apo nën nivelin e rakisë dhe bixhozit, sa që t'i gjykojmë si absolutisht të refuzuara.

Konsiderojmë se kjo i kontribuon ruajtjes së amanetit për balancim, transparencë dhe kritikë metodologjike, shkencore dhe objektive. Kështu do të mund t'i shmangemi padrejtësisë. Por sa jemi të tillë?!

Allahu na ndihmoftë dhe tek Ai mbështetemi!

SI T'I REZISTOJMË KULTURËS GLOBALE?

Bota islame sot përballet me rreziqe të shumta, të cilat cenojnë identitetin kulturor dhe civilizues të saj. Globalizmi, për shembull, paraqet rrezik permanent për bazën e saj fetare dhe botëkuptimet e tjera të saj për jetën dhe gjithësinë.

Muslimanët padyshim se janë duke kaluar në një rën prej etapave më të errëta të historisë. Ata janë dobësuar shumë dhe largimi i tyre prej mësimave dhe jetës fetare pati si pasojë përçarjen, copëtimin, prapambetjen, izolimin, nënshtrimin dhe poshtërimin. Pastaj, kolonizimi, që u mishërua me idenë e shfarosjes, jo vetëm që vodhi dhe plaçkiti pasuritë e tyre, por vrau, internoi dhe burgosi shumë muslimanë. E sikur të mos mjaftonte kjo, ata filluan sulme të pamëshirshme ndaj bindjeve, moralit dhe të shenjtave të tyre. Ata sulmuan Kur'anin dhe Muhammedin,

[*alejhis salatu ves selam*] në mediat e tyre, sikurse që u tallën dhe përqeshën bindje dhe parime të tjera islame.

Fatkeqësisht, këto dukuri janë bërë si të thuash sinonim i muslimanëve dhe botës islame në kohën moderne në të cilën po jetojmë. Por cilat janë rrugët e ruajtjes së identitetit islam në kohën kur muslimanët po ballafaqohen me këto sfida dhe sprovat të globalizmit?

Zgjidhja hyjnore

Allahu i Madhëruar thotë:

Ata që e mohuan të vërtetën janë miq të njëri-tjetrit. E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoni e të kujdeseni për njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmuje e madhe në tokë.” (el-Enfalë, 73)

Imam Ahmedi transmeton, në Musnedin e tij, nga Theubani se Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

*Ka gjasa që armiqtë t’iu vërsulen (rrethojnë) nga çdo anë ashtu siç ngrënësit rrethojnë pjatën e tyre. O i Dërguari i Allahut, a (do të ndodhë kjo) për shkak se atë ditë do të jemi pak? – e pyeti Theubani. Jo, atë ditë ju do të jeni shumë – i tha Pejgamberi, [*alejhis salatu ves selam*] – por do të jeni si shkuma e detit. Nga zemrat e armiqve tuaj do të nxirret frika prej jush, ndërsa në zemrat tuaja do të hidhet dobësia. E ç’është dobësia? – e pyetëm, rrëfen Theubani. - Dashuria për dynjanë dhe urrejtja për vdekjen – tha Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*].”*

Për ajetin e mësipërm, dijetarët dhe komentuesit e Kur’anit kanë dhënë shpjegime brilante, prej të cilave do të shkëpusim paragrafët në vijim: “Metodologjia dinamike e kësaj feje i qaset aktualitetit gjithmonë me mjetet përkatëse... E për shkak se injoranca (joislamizmi) nuk është vetëm një teori por paraqet një formacion dinamik, atëherë edhe kthimi i njerëzve në fenë e Allahut nuk duhet kurrsesi të përkufizohet vetëm në teori, ngase kështu mjetet nuk do të ishin përkatëse dhe reagimi nuk do të ishte ekuivalent me sfidën e përqendruar në një formacion dinamik, e lëre më të jetë në epërsi ndaj saj... Dhe ashtu sikurse që shoqëria islame është e gjallë dhe dinamike, dhe ashtu sikurse muslimanët

ndihmohen, përkrahen dhe janë miq ndërmjet vete, po kështu edhe pjesëtarët e shoqërisë joislame janë të lidhur ndërmjet vete dhe janë miq të njëri-tjetrit..."

Gjërat, nga vetë natyra e tyre, janë kështu... Pjesëtarët e shoqërisë joislame nuk funksionojnë si individë të pavarur, por ata veprojnë si një organ i vetëm. Individët e saj janë të lidhur ndërmjet vete, si nga natyra po ashtu edhe nga qeverisja. Kështu, Islami nuk mund t'iu rezistojë dhe të përballet me ta, përderisa shoqëria islame nuk merr një trajtë dhe formë tjetër, që shquhet për veçoritë dhe karakteristikat e saj. Ndryshe, nëse nuk përballet me ta si një shoqëri e vetme, individët e të cilës janë miq ndërmjet vete, atëherë vetë individët e saj do të jenë në sprovë nga shoqëria joislame (inJORante) dhe kjo është e keqja më e madhe:

...E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoni e të kujdeseni për njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmujë e madhe në tokë." (el-Enfalë, 73)

Mbaron koment.

Realiteti i inJORancës bashkëkohore dhe mënyra e sfidimit të saj

'Globalizmi' është një terminologji e re që nënkupton një sistem që synon ndërtimin e një perandorie që mbizotëron mbi të gjithë popujt, pa marrë parasysh vlerat, kulturën, civilizimin, kufijtë gjeografikë dhe politikën.

Globalizmi është një formë tjetër e ballafaqimit kulturor që Perëndimi bën kundër identiteteve, kulturave dhe civilizimeve të popujve në përgjithësi, e ndaj muslimanëve në veçanti.

Kjo kulturë, me këto botëkuptime, është në kundërshtim të plotë me Islamin. Po ashtu, ajo bie ndesh edhe me vetë ligjet ndërkombëtare, si edhe me ligjet për pluralizmin fetar dhe kulturor. Kultura perëndimore amerikane, me këtë dinamikë, nuk është tjetër veçse një alarm për shkatërrimin e rendit dhe sigurisë në botë, veçanërisht sigurisë së botës islame.

Globalizmi dhe universalizmi

'Universalizmi', - si term që shpreh ambiciet për përparim, zhvillim, progres, prosperitet në nivel mbarëbotëror dhe për përvetësimin e të gjithë asaj që është e mirë dhe e dobishme, po kështu në nivel botëror, - është diametralisht i kundërt me 'globalizmin', që nënkupton shtypjen, shkatërrimin, zhdukjen dhe plaçkitjen e çdo gjëje, që është karakteristikë dhe veçori e dikujt, pra që nuk është globale.

Pra, universalizmi nënkupton të qenët i hapur ndaj *tjetrit*, me dëshirën për të marrë prej tij dhe për t'i dhënë atij. Kjo edhe është e kërkuar në raportet ndërmjet njerëzve dhe shteteve, kuptohet sipas rregullave dhe kritereve të përcaktuara. Ndërsa globalizmi nënkupton zhdukjen dhe shkatërrimin e çdo gjëje me të cilën dallohet *tjetri*.

Islami, i cili na urdhëron që të jemi të hapur ndaj tjetrit dhe të përfitojmë prej tij për aq kohë sa kjo nuk bie në kundërshtim me parimet kur'anore dhe pejgamberike, përputhet me universalizmin, por bie ndesh me globalizmin, që punon për të imponuar modelin e tij kulturor, pa i fshehur fare aspiratat për mbizotërim ekonomik dhe politik. Globalizmi është i "përkushtuar" për t'i shkatërruar identitetet fetare dhe kulturore të popujve, duke bërë që popujt apo shtetet e pasura të fitojnë edhe më shumë, ndërsa shtetet e varfra të zhyten edhe më thellë në varfëri, skamje dhe prapambeturi. Globalizmi ka si objektiv shpërbërjen e disa shteteve, kulturave, organizatave, shoqërive, kulturave dhe feve, si dhe mbizotërimin politik, ekonomik, kulturore, e madje edhe ushtarak, për të arritur kështu më lehtë deri tek shfrytëzimi i pasurive dhe të mirave të popujve.

Fakti që Amerika dhe Evropa e kanë kuptuar se muslimanët janë shumë të interesuar për krijimin e një organi ndërkombëtar që do të ruante nderin, vlerat dhe pasuritë e tyre, ka bërë që Amerika dhe Evropa të mos lënë rrugë e mjet pa përdorur, vetëm e vetëm që t'i japin fund Islamit dhe muslimanëve, duke filluar nga format brutale ushtarake e deri tek lufta intelektuale dhe kulturore. Është ndërmarrë një mision ekskluziv që merret

vetëm me luftimin e Islamit. Kjo bëhet nën hijen e motive të rreme dhe lajthitëse, si:

1. Demokracia
2. Pluralizmi politik
3. Të drejtat e njeriut (duke nënkuptuar këtë vetëm njeriun perëndimor)
4. Politikat e tregut ndërkombëtar dhe mbizotërimit të tij

Alternativa

Opsionet e përmendura më lart, dhe të tjerat të përmendura në raste të tjera, ne nuk i duam për shkak se kemi alternativën tonë, Islamin, te saktësia dhe efikasiteti i të cilit ne besojmë fuqishëm. Edhe po të supozonim se lejohen alternativa të tjera, atëherë e mira nuk do të duhej ndërruar kurrë me të keqen. Por si është puna kur Islami nuk ka alternativë? Allahu ka thënë:

Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni.” (el-En’amë, 153)

Duke u bazuar në këtë, konsiderojmë se globalizmi është forma më e re e kolonizimit bashkëkohor, është thirrje për skllavërimin e sërishëm të njerëzve, ndërkohë që nënat e tyre i kanë lindur të lirë.

Më poshtë do të përshkruajmë disa prej mënyrave të ruajtjes së identitetit islam nga shkrirja apo tkurrja në gjirin e kulturës shkatërruese të globalizmit:

1. Luftimi i injorancës që dëmton Islamin.
2. Mbushja e boshllëkut shpirtëror, intelektual dhe kulturor tek muslimanët.
3. Luftimi i dukurisë së ‘islamofobisë.’
4. Mosnënshtrimi ndaj filozofirave dhe kulturave perëndimore. Prej tyre duhet marrë vetëm ajo që përputhet me fenë tonë dhe vetëm ajo që na duhet.

5. Ruajtja e shoqërisë nga sëmundjet perëndimore, si: stresi, zhgënjimi, ndjenjat e nihilizmit, jetës së paqëllimtë, egoizmit, individualizmit etj.
6. Zhvillimi i jetës larg stilit perëndimor dhe luftimi i imitimit të verbër. Ajo që ne duhet të marrim nga Perëndimi janë të mirat e tyre, që janë të lejuara edhe në fenë tonë, ngase *'urtësia është gjë e humbur e besimtarit, të cilën ai duhet ta marrë kudo që ta gjejë!'*
7. Mburria dhe krenaria me historinë tonë të lavdishme dhe me personalitetet tona të ndritura. Po kështu, puna dhe angazhimi për të ruajtur identitetin tonë individual.
8. Puna në drejtim të përmirësimit të imazhit të shoqërisë islame dhe përhapja e mirësive të Islamit.
9. Njohja e metodologjisë islame për reformimin pozitiv kulturor, duke kaluar nga e keqja në të mirën, nga shkalla e ulët në atë të lartën.
10. Fuqizimi i lidhjeve me Allahun e Madhëruar, realizimi i adhurimit dhe sinqeritetit kulmor në raport me Të.
11. Startimi me Kur'an dhe Sunnet në të kuptuar, dije, meditim dhe përsiatje.
12. Zhvleftësimi i bindjeve, ideve dhe teorive të gabuara, duke e bërë këtë nën hijen e argumenteve racionale.
13. Thirrja e njerëzve që ta braktisin moralin e ulët dhe të fisnikërohen me moral të lartë dhe të mirë.
14. Themelimi i një shoqërie islame, në gjirin e së cilës do të krijoheshin gjenerata të tëra muslimanësh, që do të jetonin sipas vlerave dhe edukatës së saj.
15. Rishikimi i planprogrameve mësimore si dhe mbikëqyrja e mjeteve të informimit. Largimi nga skema programore e çdo gjëje që promovon antivlera, qoftë dokumentar, film, serial apo çfarëdo tjetër qoftë.
16. Aftësimi i fëmijëve muslimanë përballë kësaj lufte ideore dhe këtyre kulturave shterpe dhe denigruese të Perëndimit.

Për realizimin e këtyre qëllimeve, nuk mjafton vetëm angazhimi qeveritar. Patjetër se çdo musliman/e, pavarësisht pozitës, duhet ta luajë

rolin e tij/saj pozitiv, ngase kështu ata edhe bartin një pjesë të përgjegjesisë.

Revista Javore Kuvajtiane 'Mexhel-letu el-muxhtemeë'

5/10/2008

PARAMETRAT EDUKATIVË NË MENDIMET E IMAM NEVEVIUT [ALLAHU E MËSHIROFTË] -1-

Dijetarët tanë, nga radhët e selefëve [gjeneratave të hershme], i kanë kushtuar rëndësi të madhe Kur'anit Fisnik, qoftë duke e nxënë përmendsh, qoftë duke e studiuar dhe mësuar, apo edhe duke e komentuar. Po kështu, krahas kësaj, ata shfaqën interesim edhe për edukatën e studiuesve të Kur'anit dhe hafëzëve, duke shkruar edhe libra dhe punime voluminoze, siç janë , sa për ilustrim, veprat: '*Ahlaku Hameletil Kur'an'* e el-Axhurr-riut , '*Et-Tibjan fi arabi Hameletil Kur'an'* e Imam Neveviut etj. Në fakt, libri i Imam Neveviut është edhe objekt studimi i punimit tonë. Këta autorë i morëm vetëm si shembuj, përndryshe ata që e kanë trajtuar këtë çështje në librat dhe punimet e tyre janë të shumtë.

Ky libër i Imam Neveviut më ka 'robëruar' për kohë të gjatë. Ndikimi i tij në shpirtin dhe formimin tim ideor personal ka qenë i dukshëm.

Në profesionalizmin e Imam Neveviut, në fushën e edukimit dhe arsimit, ndikim të jashtëzakonshëm ka pasur shoqërimi i tij i gjatë me Kur'anin, gjë të cilën mund ta vërejë çdokush që e lexon me përkushtim dhe seriozitet librin e tij. Për ndikimin që lë Kur'ani Fisnik tek lexuesit e tij, na flet Sejjid Kutbi: '*Ky Libër ka qenë burim i vetëm dijeje, edukimi, udhëzimi dhe formimi për*

një gjeneratë të rrallë të njerëzimit..., gjeneratë shoqen së cilës historia nuk do ta nxjerrë më dhe as që e ka nxjerrë më parë. Pra, kjo është gjenerata e sahabëve [Allahu qoftë i kënaqur me ta] të cilët shkruan në histori atë ngjarjen madhore, së cilës shkenca ende nuk ia ka dhënë hakun që meriton.'

Allahu i Madhëruar na nderoi edhe neve, duke na bërë prej atyre që bartin mesazhin dhe fjalën e Tij në këtë vend të shenjtë, në qytetin e Pejgamberit [alejhis salatu ves selam]. Kështu që e pamë si të domosdoshme, si obligim, që për temën në fjalë të shpalosim para jush të vërteta dhe mësimë edukative të shkëputura nga përvoja e këtij gjeniu dhe kolosi, që rrallë përsëriten në histori.

Kritere edukative-arsimore

Edukata dhe kriteret e përmendura në këtë libër të Imam Neveviut, edhe nëse janë vënë drejtpërdrejt për ata që merren ekskluzivisht me nxënien përmendësh dhe studimin e Kur'anit Fisnik, studentë apo profesorë qofshin, gjithsesi janë të vlefshme dhe të aplikueshme për të gjitha fushat dhe specializimet, si dhe për të gjithë studentët dhe profesorët, duke aplikuar kështu rregullin e famshëm se 'Mësimi nuk merret nga ekskluziviteti i shkakut, por nga përgjithësimi i tekstit.'

Sot, fatkeqësisht, shumë profesorë, edhe nëse bartin tituj të lartë akademikë, janë tërësisht të zhveshur nga kjo edukatë dhe larg këtyre parimeve dhe kritereve që Imami ynë i dashur, Imam Neveviu, i përmbloodhi në librin e tij. Jo rrallë i sheh këta profesorë të mërrolur, të dhunshëm, fyes, ofendues, ziliqarë dhe jo rrallë ndodh që në Ministrinë e Arsimit të bëhen ankesa për profesorë të tillë.

Konsideroj se libri që kemi përpara është si një kandil ndriçues që iu shndrit rrugën atyre që duan të përkujtojnë dhe falënderojnë!

Kënaqësia e Allahut të Madhëruar

Le të përjetojmë disa çaste nga shoqërimi me këtë libër. Imam Neveviu [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Gjënë e parë që mësuesi dhe studenti duhet ta

kenë parasysh është që me veprën e tyre ta synojnë kënaqësinë e Allahut. Fudajl Ibn Ijjadi ka thënë: *Braktisja e veprës për hir të njerëzve është syfaqësi (rija), veprimi për hir të njerëzve është shirk (idhujtari), ndërsa sinqeritet (el-ihlas) është që Allahu të të shpëtojë prej të dy gjendjeve...Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] ka thënë:*

Kush mëson një dituri, me të cilën kërkohet kënaqësia e Allahut, por këtë e bën për ta realizuar ndonjë objektiv të kësaj bote, ai nuk do ta ndiejë erën e Xhenetit në Ditën e Kiametit!"

Më pas, Imam Neveviu flet për sinqeritetin e mësuesit dhe studentit, duke sqaruar edhe disa gabime në të cilat bien shumë prej tyre. Ne këtu po shkëpusim pjesë nga fjalët e tij.

Gabimet e mësuesve

Sinqeriteti i mësuesve: Mësuesi duhet të ketë kujdes që të mos jetë i preokupuar vetëm me numrin e shumtë të atyre që e pasojnë atë dhe mësojnë prej tij. Duhet të mos urrejë që edhe mësuesit e tjerë të kenë studentë. Kjo fatkeqësi ka kapluar shumë mësues dhe është një shenjë që reflekton qëllimin jo të pastër të tij. Ky është argument i prerë se ai njeri nuk synon kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, ndryshe nuk do ta urrente një gjë të tillë. Aliu [Allahu qoftë i kënaqur me të] ka thënë: *"O bartës të Kur'anit (O hafëzë dhe studiues)! Apo ka thënë (transmetuesi dyshon): O bartës të diturisë! Punoni sipas saj, ngase dituri është kur njeriu punon sipas asaj që di dhe dituria e tij përputhet me veprën e tij. Do të ketë njerëz që bartin dituri por që dituria nuk kalon klavikulën¹³ e tyre; punët e tyre i kundërshtojnë fjalët e tyre, ndërsa punët e fshehta i kundërshtojnë punët e tyre publike. Ulen në grupe dhe i mburren njëri-tjetrit, saqë njeriu do t'i hidhërohet bashkëulësit të tij nëse ulet (mëson) edhe tek tjetri..."*

Këtyre nuk iu pranohen veprat tek Allahu përderisa janë në ndeja të tilla!

¹³ Klavikula është ashti tek fyti dhe krahu.

Mësuesi duhet të jetë i zellshëm për mësimin e studentëve, duke i favorizuar ata madje edhe ndaj interesave jo shumë të nevojshme të jetës së tij. Kur të ulet për t'i mësuar ata, ai duhet t'i harrojë të gjitha problemet e tij. Duhet të jetë këmbëngulës që t'i bëjë ata ta kuptojnë dhe secilit prej tyre duhet t'i flasë aq sa kupton. Nuk duhet t'i flasë shumë atij që kupton pak dhe, anasjelltas, nuk duhet t'i flasë pak atij që kupton më shumë. Kohë pas kohe, ai duhet t'iu rikthehet gjërave të mësuara përmendsh dhe t'i përsërisë ato, duke i lëvduar ata që meritojnë lëvdata, por duke mos e tepruar, sidomos nëse ka frikë se kjo ngjall tek ata ndjenjën e vetëpëlqimit. Ndërsa të padisiplinuarit duhet t'i qortojë, por jo ashpër, sidomos nëse qortimi mund të sjell më shumë dëm se dobi.

Po kështu, nuk duhet të ketë zili ndaj zgjuarsisë së ndonjërit prej tyre, ngase nëse zilia është e ndaluar në përgjithësi, atëherë në raportet mësues – studentë, që në një formë janë si lidhja prind – fëmijë, ajo është akoma edhe më e ndaluar. Pastaj, kjo zgjuarsi e studentit sigurisht se do t'i sjellë atij të mira në Ahiret, sikurse që do t'i sigurojë autoritet dhe famë edhe në këtë botë.

Mësuesi duhet të jetë fytyrëqeshur, i ngrohtë dhe i afërt. Ai duhet të interesohet për gjendjen e tyre dhe të pyesë për ta nëse mungojnë. Dijetarët kanë thënë: Le të mos e largojë askënd nga klasa për shkak të qëllimit jo të mirë.

Rrëfimi ynë për moralin dhe tiparet e mësuesit shembullor nuk mbaron këtu. Në artikullin vijues do të flasim për metodologjinë të cilën Imami e sheh si të domosdoshme për mësuesin gjatë mësimdhënies. Po kështu, do të flasim edhe për nevojën dhe rëndësinë e modelit shembullor që duhet të përvetësojë mësuesi ndërsa ushtron detyrën e edukatorit dhe mësimdhënies.

PARAMETRAT EDUKATIVE NË MENDIMET E IMAM NEVEVIUT
[ALLAHU E MËSHIROFTË] -2-

Në numrin e kaluar diskutuam për disa nga tiparet, cilësitë, parimet, rregullat edukative, përvetësimet dhe pajisjet të cilat duhet t'i posedojë mësuesi gjatë kohës që jep mësim. Edhe në këtë artikull do të vazhdojmë diskutimin tonë rreth edukatës dhe cilësive të mira të mësuesit, me të cilat ai duhet ta kompletojë personalitetin e tij. Po kështu, do të bëjmë fjalë edhe për moralin dhe edukatën të cilës duhet t'i përmbahet studenti.

Imam Neveviu [*Allahu e mëshiroftë*] ka thënë:

Karakteri i mirë: Mësuesi patjetër duhet të mishërohet me virtyte të aprovuara nga feja. Ai duhet të pajiset me veti të lëvduara dhe sjellje të kënaqshme, për të cilat udhëzoi Allahu, si: asketizmi në dynja dhe mosdhënia pas saj, bujaria, zemërgjerësia, morali i mirë dhe buzëqeshja, duke mos dalë jashtë kufijve të normales kurrë. Pastaj butësia, durimi, fitimi hallall, përrulja, nënshtrimi, urtësia, frikërespekti, modestia, shmangia të qeshurit të tepërt dhe shakasë, kujdesi për pastërtinë fetare si: prerja e thonjve, shkurtimi i mustaqeve, rregullimi i mjekrës, largimi i erërave të pakëndshme dhe veshjeve të papëlqyera...

Mësuesi duhet të ketë kujdes nga zilia, syfaqësia, vetëpëlqimi, nënçmimi dhe poshtërimi i tjetrit, edhe nëse është nën pozitën e tij... Ai duhet të veprojë gjithmonë vetëm për hir të Allahut, i vetëm apo në shoqëri qoftë, dhe të jetë shumë i kujdesshëm për këtë. Po kështu, duhet të mbështetet tek Allahu për çdo punë të tij! Duhet të jetë i butë dhe mirëdashës ndaj

studentëve dhe t'iu bëjë mirë atyre, varësisht nga gjendja e tyre, duke përfillur kështu hadithin e Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*]:

Vërtet, njerëzit iu pasojnë juve dhe ata për mësimin e fesë (prej jush) do t'iu vinë nga (të gjitha) anët e botës, e kur t'iu vijnë, atëherë trajtojini mirë ata!" [Transmetojnë Tirmidhiu dhe Ibni Maxheh ndërsa Albani në Daif Sunen et-Tirmidhi, 2801, e cilëson daif - të dobët.]

Mësuesi duhet t'i këshillojë shumë nxënësit, sidomos në lidhje me Allahun dhe Librin e Tij. Po ashtu, ai duhet t'i këshillojë nxënësit që t'i nderojnë lexuesit e Librit të All-llahut, t'i udhëzojnë ata, të jenë të butë ndaj tyre dhe t'i ndihmojnë ata aq sa të kenë mundësi. Mësuesi duhet të jetë transparent në mësimin e tij, të sillet me butësi dhe t'i nxisë e t'i stimulojë nxënësit për mësim. Për t'i motivuar, kohë pas kohe, duhet t'iu përkujtojë mirësitë e mësimin të Kur'anit, në veçanti dhe të gjitha shkencave të tjera fetare, në përgjithësi. Kjo është rruga e *arifinëve* (term sufist për një grup njerëzish që janë të përkushtuar në lutjet dhe adhurimet e tyre) dhe robërve të sinqertë të Allahut. Kjo është dhe shkallë e të dërguarve të Allahut [*alejhimus salatu ves selam*]. Ai duhet ta mëshirojë studentin dhe të interesohet për të mirat e tij, ashtu siç interesohet për fëmijën apo edhe për veten e tij. Ai duhet ta trajtojë studentin si fëmijën e tij, duke duruar eventualisht edhe ndonjë sjellje të pahijshme, apo duke arsyetuar edhe ndonjë mungesë edukate që mund ta shfaqë ai herë pas here, ngase njeriu nuk mund t'iu shpëtojë mangësive. Ai duhet t'ia dojë atij atë të mirë që e do për vete dhe ta urrejë atë të keqe që e urren për vete. Ai nuk duhet të shfaqë mendjemadhësi para studentëve. Përkundrazi, duhet të jetë i butë dhe modest me ta, sidomos kur dihet se këto tipare janë vlerësuar shumë, madje edhe në raport me njerëzit e thjeshtë e lëre më me ata që i ka si bijtë e tij dhe të cilët janë përkushtuar për mësimin e Kur'anit. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë: "Tregohuni të butë ndaj atyre që i mësoni apo mësoni prej tyre..."

Imam Neveviu [*Allahu e mëshiroftë*] i qaset edhe një çështjeje tjetër, asaj të *mësimin gradual*. Imami thotë:

Afrimi (miqësimi) me studentin: Studenti duhet pajisur gradualisht me morale të larta, me sjellje të mira, me trajnim për vëzhgim shpirtëror, me kujdes dhe seriozitet në të gjitha çështjet, publike të fshehta. Mësuesi duhet ta stimulojë dhe ta nxitë me thënie të urta për sinqeritetin, qëllimet e mira, vëzhgimin e Allahut në çdo gjë, duke ia bërë me dije se vetëm kështu i hapen dyert e njohurive, i zgjerohet gjoksi, ndërsa nga zemra i shpërthejnë burime urtësisht dhe dijes, si dhe i jepet bereqet në diturinë dhe gjendjen e tij, e po ashtu bekohet me sukses në fjalët dhe veprat e tij.

Moral dhe edukatë tjetër të studentit, të cilave mësuesi duhet t'ua kushtojë rëndësi, është edhe: ruajtja e duarve të tij nga gjërat e kota, ruajtja e shikimit të tij nga gjërat e panevojshme, të ulurit e tij në drejtim të kibles duke qenë i pastër (me abdes), të ulurit e tij me dinjitet, të veshurit e rrobave të bardha dhe të pastra, të ulurit në gjunjë e jo këmbëkryq. Abdullah Ibni Mes'udi ligjëronte duke qenë në gjunjë. Mexhlisi (vendi i ligjërimin) duhet të ketë hapësirë për të gjithë, ngase "*Mexhliet më të mira janë ato më të gjerat!*" – thoshte Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*].

Prej gjërave që mësuesi duhet të ketë kujdes më së shumti është që të mos e shndërrojë Kur'anin në mjet përfitimi. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

Lexojeni Kur'anin dhe punoni sipas tij. Mos iu largoni leximit të tij, mos i tejkaloni kufijtë e tij, mos hani prej tij dhe mos e bëni atë shkak të shumimit të të mirave të dynjasë." [Albani në Sahihul xhamii-s-sagiri ve zijadetihi, 1/258, e cilëson autentik.]

Ndërsa sa i përket marrjes së shpërblimit për mësimin e Kur'anit, dijetarët ndajnë mendime të ndryshme. Ebu Hanife, Zuhriu dhe të tjerë, mendojnë se një gjë e tillë ndalohet, ndërsa të tjerë, si Hasan Basriu, Sha'biu dhe Ibni Sirini e lejojnë këtë, me kusht që kjo të mos jetë kushtëzuar paraprakisht. Ndërsa disa dijetarë të tjerë, si Atau, Imam Maliku, Imam Shafiu etj., mendojnë se një gjë e tillë lejohet pa kushtëzime.

Kështu, në përfundim të këtij artikulli, të dytit me radhë, përfunduam edhe me edukatën dhe moralin që Imam Neveviu [*Allahu e mëshiroftë*] e sheh si të domosdoshme për mësuesin, ndërsa në artikullin vijues do të fokusohemi në edukatën e studentit dhe moralin të cilin duhet ta ketë ai gjatë kohës që kërkon dituri.

PARAMETRAT EDUKATIVË NË MENDIMET E IMAM NEVEVIUT [ALLAHU E MËSHIROFTË] -3-

Edukata e nxënësit të Kur'anit

Në numrin e kaluar, tema jonë kishte në fokus edukatën, vlerat dhe moralin që duhet t'i përvetësojë mësuesi i Kur'anit. Ndërsa në këtë artikull, që paraqet një vazhdimësi të artikujve paraprakë dhe që në fakt është pjesa e fundit e tyre, në epiqendër të interesimit tonë do të jetë korpusi i vlerave dhe moralit me të cilat studenti duhet ta ndërtojë personalitetin e tij.

Imam Neveviu [*Allahu e mëshiroftë*] ka thënë: Krejt ajo që kemi përmendur për moralin dhe edukatën e mësuesit vlen edhe për studentin. Studenti duhet t'i shmanget çdo gjëje që e pengon nga mësimi, me përjashtim të gjërave që i ka të domosdoshme. Ai duhet ta pastrojë zemrën nga njollat për të qenë në gjendje që ta pranojë Kur'anin, ta mësojë përmendsh atë dhe të përfitojë (në kuptim të vlerave) prej tij. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

...Vini re! Në trup është një copë mishi, që nëse shëndoshet, shëndoshet i tërë trupi, e nëse prishet (sëmuret), prishet i tërë trupi. Vini re! Kjo është zemra!"

"Zemra duhet të përgatitet për Kur'anin, ashtu siç përgatitet toka për mbjellje"- thotë një fjalë e urtë.

Modestia ndaj mësuesit

Studenti duhet të jetë modest dhe i sjellshëm ndaj mësuesit të tij, edhe nëse ai është më i ri apo me më pak autoritet. Duhet të jetë modest ndaj dijes ngase vetëm kështu mund ta fitojë atë. Duhet ta respektojë mësuesin dhe

të konsultohet me të për punët e tij, duke e pranuar mendimin e tij mu ashtu sikurse që i sëmuri e pranon mendimin e mjekut të singërtë...

Ai nuk duhet të marrë dije prej çdo njeriu, përveçse prej atij që është profesionist, është i devotshëm dhe i ditur. Selefitë thoshin: *'Kjo dituri është fe, andaj shikoni se prej kujt po e merrni fenë tuaj!'*

Ai duhet të ketë konsideratë për mësuesin e tij, të besojë në të qenët e tij si i denjë për mësues dhe, po kështu, ta konsiderojë atë si më të mirin e mësuesve të kategorisë së tij. Kështu, ai do ta ketë më të lehtë përfitimin e njohurive prej tij. Në të kaluarën, kishte studentë që, para se të shkonin tek mësuesi, jepnin lëmoshë dhe luteshin: *'O Zoti im! Mbuloja të metat mësuesit tim, ndërsa mua mos më privo nga bereqeti i diturisë së tij!'*

Rebiu, nxënësi i Shafiut [Allahu i mëshiroftë që të dy] rrëfen për veten e tij: *'Nuk mund të merrja guximin që të pija ujë, ndërsa Shafiu më shikonte, jo për tjetër, por nga frikërespekti që kisha për të!'*

Kemi transmetuar¹⁴ se Aliu [Allahu qoftë i kënaqur me të] ka thënë: *'Mësuesi ka të drejtën ekskluzive që kur t'i përshëndesësh të gjithë, atë ta veçosh me përshëndetje, të ulesh para tij dhe të mos bësh me dorë në drejtim të tij. Mos luaj me sy dhe as mos thuaj: Filani mendon ndryshe nga kjo që thua! Po kështu, mos përgojo askënd dhe mos pëshpërit me shokun që ke afër. Kur të ngrihet, mos e kap nga rrobat, dhe nëse është lodhur dhe përton, mos iu lut shumë për ndonjë gjë. Mos u ngop kurrë duke qëndruar me të!'*

Studenti duhet të edukohet në frymën e këtyre fjalëve të mrekullueshme që ka thënë Aliu [Allahu qoftë i kënaqur me të]. Nëse rastis që mësuesi mungon, atëherë ai nuk duhet të lejojë ofendimin e tij, përndryshe duhet të largohet nga ato ndeja dhe mexhlise.

¹⁴ Shënim: Thënia e Imam Neveviut [Allahu e mëshiroftë] "Kemi transmetuar" (ar. revejna) nënkupton se senedi i tij lidhet me thënien apo hadithin të cilën ai e transmeton. Përkthyesi.

Studenti duhet të hyjë tek mësuesi duke qenë i zbukuruar me cilësitë që përmendëm më parë, duhet të jetë i pastër, duhet t'i ketë pastruar dhëmbët me misvak (ose brushë) dhe duhet të jetë i çliruar nga gjërat që ia rëndojnë zemrën. Nëse mësuesi ndodhet në ndonjë vend ku nuk hyhet dot pa marrë leje, atëherë ai duhet të mos hyjë pa marrë leje paraprakisht. Kur të hyjë, duhet t'i përshëndesë të gjithë në përgjithësi, ndërsa mësuesin duhet ta përshëndesë në mënyrë të veçantë. Po kështu duhet të veprojë edhe kur të largohet nga mexhlisi. Nuk bën të kalojë nëpër safe, por duhet të ulet atje ku gjen vend të lirë, përveç nëse mësuesi e thërret apo të tjerët i japin leje për një gjë të tillë. Nuk duhet ta çojë askënd prej vendit të vet. Edhe nëse dikush ia lëshon vendin përpara, ai nuk duhet të pranojë, duke pasuar kështu Ibni Omerin [*Allahu qoftë i kënaqur me të*], përpos nëse kalimi i tij përpara ka dobi për të tjerët, apo mësuesi e thërret përpara. Nuk bën të ulet në mes të tubimit dhe as në mes të dy shokëve, përveç nëse ata e lejojnë të ulet në mesin e tyre.

Po kështu, ai duhet të jetë i sjellshëm edhe me shokët dhe bashkëulësit e tij, ngase kjo tregon respekt edhe për mësuesin dhe mexhlisin e tij. Ai duhet të ulet para mësuesit si student, e jo si mësues. Nuk bën ta ngrejë zërin pa nevojë, as të qeshë dhe të flasë pa nevojë. Nuk bën të luajë me diç, as të kthehet majtas e djathtas pa nevojë. Përkundrazi, duhet të jetë i kthyer nga mësuesi dhe të dëgjojë me vëmendje ligjërimin e tij.

Shfrytëzimi i kohës

Një prej gjërave që studentin duhet t'i kushtojë rëndësi është edhe: mos insistimi për ta pyetur mësuesin kur ai nuk është i disponuar. Përkundrazi. Studenti duhet të shfrytëzojë momentet kur mësuesi është i disponuar dhe duhet të vetëpërmbahet nëse eventualisht mësuesi shfaq ashpërsi apo ndonjë tipar jo të mirë. Kjo nuk duhet ta zhgënjejë studentin dhe rrjedhimisht ta largojë prej mësuesit të tij. Jo, megjithatë studentin duhet të besojë në aftësinë e mësuesit të tij dhe nevojën për ta pasuar atë, ndërsa veprimet e tij të pahijshme t'i komentojë si qëllimmira. Nëse mësuesi sillet keq, atëherë vetë studentin le t'i kërkojë falje atij, sikur ky ka gabuar e jo ai,

ngase kjo është më e dobishme për të në këtë botë dhe në botën tjetër, sikurse që edhe zemrën e mësuesit e bën më të pastër. Të parët kanë thënë: *'Kush nuk duron nënçmimin e mësimit, do të jetojë tërë jetën nën tutelën e injorancës. E kush duron, ai do të përfitojë krenarinë e ahiretit dhe kësaj bote.'* Ibni Abbasi [*Allahu qoftë i kënaqur me të*] transmetohet të ketë thënë: *'Jam nënçmuar si kërkues (i diturisë), ndërsa jam bërë krenar si i kërkuar (për dituri).'* Sa bukur është thënë: *'Kush nuk shijon shijen e nënçmimit, qoftë edhe për një çast, do të jetojë tërë jetën i poshtëruar!'*

Studenti duhet të jetë i zellshëm për të përfituar dituri, në çdo kohë që i jepet mundësia dhe nuk duhet të kënaqet me pak, kur ka mundësi për më shumë, por nuk duhet ta ngarkojë veten tepër aq sa ta kaplojë monotonia apo ta harrojë atë që ka mësuar. Ngarkimi i vetvetes bëhet varësisht nga njeriu. Kur shkon tek mësuesi dhe ndodh që ai nuk është aty, atëherë ai duhet të presë dhe të mos shkojë. Nëse mësuesi është duke fjetur apo i zënë me ndonjë punë, atëherë ai duhet të presë derisa të zgjohet apo të lirohet nga ajo punë. Më së miri dhe më e preferuar është që të durojë derisa mësuesi të lirohet, ashtu siç kanë vepruar Ibni Abbasi [*Allahu qoftë i kënaqur me të*] dhe të tjerë.

Studenti duhet ta shfrytëzojë maksimalisht kohën e lirë, para se të jetë i zënë me problemet e jetës apo të marrë pozitë më të lartë. Prijësi i besimtarëve, Omeri [*Allahu qoftë i kënaqur me të*] ka thënë: *'Mësoni para se të udhëhiqni!'* që nënkupton: Përpiquni për t'iu bërë sa më profesionistë dhe sa më të denjë, para se të zini poste udhëheqëse apo të bëheni të pasuar, ngase kjo, sikurse edhe angazhimet tuaja të shumta, do t'iu pengojë që të mësoni. Kjo është dhe domethënia e thënies së Imam Shafiut [*Allahu e mëshiroftë*]: *'Mësoni para se të bëheni prijës, ngase atëherë nuk do të mund të mësoni më!'*

Favorizimi i vështirësive

Studenti duhet të shkojë tek mësuesi për lexim qysh në fillim të ditës dhe nuk duhet ta bëjë këtë me rend me ndonjërin prej shokëve të tij. Favorizimi i vështirësive në adhurime, për dallim nga favorizimi i kënaqësive të

epshit, është i preferuar dhe i pëlqyer. Nëse mësuesi e sheh favorizimin e tij për disa kohë si të nevojshëm (dobishëm) për ndonjë arsye fetare dhe ia bën me dije këtë studentit, atëherë ai duhet ta përfillë urdhrin e mësuesit. Studenti nuk guxon asesi t'i ketë zili ata të cilët Allahu i ka begatuar me të kuptuar më të shumtë, sikurse që nuk guxon të vetëkënaqet apo të mburret me atë me të cilën e ka veçuar Allahu. Mënyra për ta luftuar cilësinë e urryer të vetëmburrjes është që të përkujtojë se për arritjet e tij i detyrohet Allahut, ndërsa mënyra për ta luftuar zilinë është që të përkujtojë se dallimi i tjetrit me ndonjë tipar të mirë përmban ndonjë urtësi që Allahu e di, prandaj edhe nuk duhet t'i kundërvihet kësaj gjëje.

Prej edukatës, me të cilën po ashtu duhet të pajiset, është edhe të qenit në gjendjet më të mira dhe me cilësitë më të pëlqyera. Ai duhet të largohet nga çdo gjë që Kur'anit e ka ndaluar, të paktën në shenjë respekti ndaj Kur'anit. Ai duhet të largohet nga të fituarit në mënyrë të ndaluar, duhet ta ruajë nderin, duhet të jetë dinjitoz ndaj tiranëve dhe mizorëve të kësaj bote dhe të tregohet modest ndaj vepërmirëve dhe skamnorëve. Duhet të jetë i përrulur (para Allahut) me urtësi dhe seriozitet. Abdullah ibni Mes'udi [*Allahu qoftë i kënaqur me të*] ka thënë: *'Bartësi i Kur'anit (hafëzi, dijetari) duhet të dallohet gjatë natës kur njerëzit flenë, gjatë ditës kur ata hanë, duhet të dallohet me pikëllimin e tij kur njerëzit gëzohen, me të qarit e tij kur ata qeshin, me heshtjen e tij kur ata zhyten në biseda (të panevojshme apo ndaluara), me përruljen e tij kur njerëzit bëhen mendjemëdhenj...'* Fudajl Ibn Ijjadi [*Allahu e mëshiroftë*] ka thënë: *'Bartësi i Kur'anit nuk guxon të ketë nevojë për prijësit e muslimanëve, e aq më pak për të tjerët.'* Po kështu ka thënë: *'Bartësi i Kur'anit është bajraktar i Islamit, andaj nuk duhet të dëfrehet me ata që dëfrehen (me gjëra të kota), apo ta kalojë natën zgjuar (në mëkate) me ata që rrinë zgjuar dhe as të flasë dokrra me ata që flasin ashtu, për të respektuar kështu të drejtën e Kur'anit...'*

Allahu qoftë i kënaqur me Imamin tonë, Imam Neveviun dhe e shpërbleftë atë me çdo të mirë prej nesh dhe prej Islamit! Po kështu, e lusim të na bëjë të ngjashëm me të dhe dijetarët e tjerë të sinqertë. Vërtet, Allahu dëgjon,

është afër dhe i përgjigjet lutjeve tona, e fundit prej të cilave është:
Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

MËSIMI I DEVOTSHMËRISË I PËRFITUAR NGA AGJËRIMI I RAMAZANIT

Gazeta mujore “ Risaletu Tajjibe” e Universitetit Tajjibe, Medine Munevvere

01/07/2005

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve! Përshëndetjet qofshin për më të mirin e peygamberëve dhe vulën e tyre, Muhammedin [alejhis salatu ves selam], familjen, shokët dhe të gjithë ata që pasojnë rrugën e tij, gjer në amshim!

Allahu i Madhëruar në Kur'anin Famëlartë thotë:

(Ato ditë të numëruara janë) Muaji ramazan në të cilin (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni.” (el-Bekare, 185)

Imam Buhariu transmeton, në Sahihun e tij, nga Ibni Abbasi [Allahu qoftë i kënaqur me të dy] se:

I Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam] (në përgjithësi) ishte njeriu më bujar, e veçanërisht në ramazan. Xhibrili [alejhis selam] e takonte... e kur e takonte Xhibrili, atëherë i Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam] ishte më bujar me të mirat se sa era e dërguar me shumë të mira.”

Në komentim të ajetit të sipërcituar, disa prej tefsirologëve bashkëkohorë thonë: Allahu i Madhëruar e di se obligimi (i agjërimit) është diç, për kryerjen e të cilit njeriu ka nevojë për ndihmë, shtytje, mobilizim, pavarësisht se çfarë urtësie fshihet në të, në mënyrë që ai të pajtohet dhe ndahet i kënaqur me të. Kështu, ne, në Kur'an, gjejmë se Allahu së pari i thërret njerëzit me një thirrje të bukur: 'O ju besimtarë!', për t'ua përkujtuar gjendjen dhe pozitën e tyre të vërtetë (se janë besimtarë), për t'iu dëshmuar më pas se agjërimi ka qenë obligim edhe tek popujt para tyre dhe për të përfunduar me qëllimin themelor të tyre, që është përgatitja e shpirtit për devotshmëri, transparencë, ndjeshmëri dhe frikërespekt ndaj Allahut të Madhëruar:

"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim, sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm." (el-Bekare, 183)

Ja, këtu zbulohet qëllimi kryesor i agjërimit, që është devotshmëria, e cila ngjallet si ndjenjë në shpirtin e njeriut atëherë kur ky obligim kryhet si përfillje e urdhrat të Zotit dhe si favorizim i kënaqësisë së Tij ndaj çdo gjëje. Devotshmëria është po kështu mburoja që i ruan zemrat nga prishja eventuale e agjërimit me mëkate, qofshin edhe këto mendime që vetëm qarkullojnë në kokë.

Besimtarët e dinë rëndësinë e devotshmërisë, e dinë se sa shumë peshon ajo tek Allahu: ajo është ideal, realizimin e të cilit e duan shpirtit ndërsa agjërimit e kanë vetëm si mjet dhe rrugë drejt finalizimit të tij. Mu për këtë, konteksti kur'anor e sjell atë si moto dhe ideal të lartë që besimtarët duan ta realizojnë pikërisht nëpërmjet agjërimit.

"...që të bëheni të devotshëm." (el-Bekare, 183)

Kur'ani vazhdon me detaje që e lehtësojnë agjërimit apo motivojnë më shumë për kryerjen e tij. Fjala është për faktin se agjërimi kryhet vetëm në ditë të caktuara dhe nuk është obligim që duhet kryer gjatë tërë jetës.

Gjithashtu prej tij janë liruar kategori të caktuara njerëzish, si fjala vjen: të sëmurit derisa të shërohen, udhëtari derisa të vendoset etj.:

(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor) i një të varfëri. Ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për te. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju.” (el-Bekare, 184) (Fi Dhilal el-Kur’an, 1/141)

Teksti kur’anor për ‘të sëmurin dhe udhëtarin’ është i përgjithshëm dhe jo i specifikuar, gjë që nënkupton se përfshin çdo të sëmurë dhe çdo udhëtar, me kusht që pas shërimit, respektivisht kthimit në shtëpi (ose vendosjes për banim), të kompensohen ditët e lëshuara të agjërimit gjatë ramazanit. Kjo është domethënia më e saktë, që njëherësh përputhet edhe me objektivat islame për lehtësimin dhe largimin e vështirësive. Urtësia e lirimit nga agjërimi nuk është sëmundja e vështirë dhe as udhëtimi i mundimshëm, por janë vetëm sëmundja dhe udhëtimi, pa shpjegime të tjera, për arsye se feja dëshiron lehtësime e jo vështirësi për njerëz. E pranoj se ne nuk e dimë gjithë urtësinë e Allahut për përgjithësim të sëmundjes dhe udhëtimit¹⁵. Mund të ketë gjëra të tjera tek sëmundja dhe udhëtimi që Allahu i di e njerëzit nuk i dinë. Apo mund të ketë vështirësi të tjera që për momentin nuk shfaqen apo njeriu nuk mund t’i paramendojë, kështu që, përderisa Allahu nuk na e ka zbuluar shkakun e dispozitës, ne nuk e komentojmë atë. Përkundrazi. Ne zbatojmë dhe përfillim tekstet kur’anore, edhe nëse nuk i dimë urtësitë. Gjithsesi pas tyre qëndrojnë urtësi, por nuk kushtëzohet që ne patjetër t’i kuptojmë, zbulojmë apo mësojmë ato.

Kjo mbase mund të krijojë përshtypjen se, nëse veprojmë kësisoj, atëherë ata që kërkojnë lehtësime do t’ua hapin derën vetëm lehtësimeve dhe do t’i anashkalojnë adhurimet e obliguara për shkakun më të thjeshtë. Këtu qëndron edhe arsyetimi i shumë juristëve muslimanë që tregohen paksa

¹⁵ Pra, pse janë përfshirë sëmundja dhe udhëtimi, pa dhënë sqarime se për cilat udhëtime dhe sëmundje bëhet fjalë.

më të ashpër dhe që vënë më shumë kushtëzime. Por kjo, sipas bindjes sime, nuk e arsyeton kushtëzimin kur vetë teksti nuk është i tillë. Feja nuk i prangos njerëzit për t'i shtyrë që t'i kryejnë adhurimet. Besimtari e bën këtë me devotshmëri, sidomos në rastin e agjërimit, qëllimi themelor dhe esencial i të cilit është devotshmëria. Ndryshe, ai që mundohet t'i shmanget agjërimit, duke u mbështetur gjoja në këto lehtësime, ai parimisht nuk është i mirë, ngase në fakt, qysh në start, ka menduar t'i shmanget qëllimit themelor të agjërimit.

Pastaj, kjo fe është fe e Allahut, e jo fe e njerëzve dhe, rrjedhimisht, Allahu e di se plotësimi i kësaj feje bëhet nëpërmjet lehtësimeve dhe vështirësive (adhurimeve që nuk lehtësohen). Është e vërtetë se pas ndonjë lehtësime mund të ketë urtësi që nuk realizohet ndryshe vetëm se me të, e ndoshta këtu qëndron edhe sekretin pse Allahu urdhëroi që besimtarët t'i kenë parasysh lehtësimet e Tij. Nëse ndodh që njerëzit të devijojnë, atëherë kthimi i tyre në fe nuk bëhet nëpërmjet kriterëve të ashpra në dispozitat fetare, por nëpërmjet përmirësimit të edukatës së tyre dhe nëpërmjet ngjalljes së ndjenjës së devotshmërisë në shpirtat e tyre.

Por, nëse ndodh që njerëzit devijojnë dhe lajthisin në jurisprudencën mbi transaksionet (raportet ndërmjet njerëzve - ar. muamelat) dhe për përmirësimin e tyre duhen kriterë të ashpra, si ilaç adekuat për mbylljen e rrugëve për arsye të pajustificueshme (sedden li-dh-dheraië), atëherë kjo nuk do të thotë se kështu duhet të veprohet edhe në çështjen e adhurimeve, ngase ato nënkuptojnë një lidhje ndërmjet njeriut dhe Zotit, ku njerëzit e tjerë nuk kanë ndonjë interes të drejtpërdrejtë, siç kanë në rastin e dispozitave në fushën e jurisprudencës mbi transaksionet (muamelat), ku duhet ruajtur kuptimi sipërfaqësor i tekstit. Teksti sipërfaqësor në fushën e adhurimeve nuk hyn në punë, përderisa nuk ngrihet mbi themelet e devotshmërisë së shpirtit. E kur të arrihet devotshmëria, atëherë askush nuk shmanget prej saj dhe nuk merret parasysh lehtësime (ar. ruhsa), veçse në rast se ai shihet si prioritar dhe se përfillja e tij paraqet adhurim për Allahun. Ndryshe, po qe se i ashpërsojmë

të gjitha dispozitat në adhurime apo anojmë nga ngushtimi (largimi) i lehtësimeve që vetë feja i ka bërë, atëherë kjo do të paraqiste problem për ata që kanë nevojë për lehtësime dhe nuk do të sillte asnjë dobi në drejtimin dhe udhëzimin e të devijuarve. Më së miri është që gjërat e kësaj feje t'i marrim në formën qysh i do Allahu i Madhëruar.

Gazeta mujore “ Risaletu Tajjibe” e Universitetit Tajjibe, Medine Munevvere
01/05/2006

AJO QË FSHEHIN NË ZEMRAT E TYRE ËSHTË EDHE MË E MADHE

Allahu i Madhëruar i ndaloi besimtarët që të marrin për miq jomuslimanët.
Ai ka thënë:

O ju që besuat, mos i zini për miq të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj, ata nuk pushojnë së vepruari në dëm tuajin, u dëshirojnë çka u mundon juve. Urrejtja kundër jush duket nga gojët e tyre, por ajo që fshehin në gjokset e tyre është edhe më e madhe. Ne pra, ua kemi sqaruar faktet nëse ju i kuptoni.” (Ali Imran, 118)

Allahu, po kështu sqaroi se armiqtë, me t'iu dhënë shansi dhe mundësia e parë, nuk do të ndalen së fyeri, ofenduari dhe dëmtuari muslimanët, madje ëndërrojnë që muslimanët t'i kthejnë në jobesimtarë:

Nëse ata ia dalin t'ju mundin, ata do të jenë armiqtë tuaj, do të zgjasin duart e veta dhe gjuhët e veta kundër jush, duke ju përbuzur, sepse ata dëshirojnë të mos besoni.” (el-Mumtehine, 2)

Kjo ëndërr apo dëshirë është pothuajse tek të gjithë jobesimtarët, gjë të cilën e vërteton edhe Kur'ani:

Shumë ithtarë të librit (jehudi, të krishterë), edhe pasi u është bërë e qartë e vërteta, nga vetë zilia e tyre personale, dëshiruan që pas besimit tuaj t'iu kthejnë në mosbesimtarë. Pra ju lërin dhe largohuni prej tyre derisa All-llahu ta sjellë urdhrin e vet. All-llahu ka mundësi për çdo send.” (el-Bekare, 109)

Po kështu, Allahu na tregon në Kur'an se janë pikërisht jomuslimanët ndezës të *fitneve* (përçarjeve, konflikteve, luftërave) dhe është Allahu i Madhëruar Ai që e fik zjarrin e ndezur prej tyre:

Jehuditë thanë: "Dora e All-llahut është e shtrënguar!" Qofshin të shtangura duart e tyre dhe qofshin të mallkuar, pse thanë atë. Jo, duart e Tij janë të shkira. Ai furnizon ashtu si të dojë. Kjo që t'u zbrit ty do t'u shtojë disave prej tyre (nga paria fetare) largimin dhe mohimin. Ne ndërmjet tyre hodhëm armiqësi dhe urrejtje, që do t'u vazhdojë deri në ditën e kiametit. Sa herë që ndezën zjarr për luftë, All-llahu e shoi atë, e ata përpiqen për shkatërrime në tokë. All-llahu nuk i do ngatërrestarët.” (el-Maide, 64)

Kur'ani na rrëfen se idhujtarët dhe ithtarët e librit (çifutët dhe të krishterët) shpifën për personalitetin e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]; e akuzuan për probleme mentale, si dhe i përshkruan cilësi të urryera. Jomuslimanët janë të njëjtë që të gjithë dhe, sado që ne të jemi të sjellshëm me çifutët dhe sado të jemi transparentë, ata kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ne, por do të na thonë mu ashtu siç i thanë Musait [*alejhis selam*]:

Ata thanë: "Me çfarëdo argumenti të na vish që të na magjepsësh (largosh nga feja që kemi), ne nuk do të besojmë ty"." (el-A'rafë, 132)

Sado që të lëshojmë pe nga të drejtat tona, sado që t'iu japim nga të mirat tona, ata nuk do të pajtohen përderisa ne të mos pasojmë fenë, besimin dhe moralin e tyre. Ata janë njerëz që nuk ngopen ndryshe veçse duke thithur gjakun tonë, duke plaçkitur pasuritë tona, duke grabitur tokat tona, ndërsa urrejtja dhe smira kundër Islamit dhe muslimanëve janë rrënjosur thellë në

zemrat e tyre. Armiqësia e tyre kundër nesh qarkullon në çdo arterie të trupit të tyre. Këto të vërteta mund t'i kuptojmë shumë qartë me një shpalosje të argumenteve kur'anore dhe peygamberike për çështjen në fjalë. Sa mirë do të kishte qenë sikur këtij problemi këtu t'i vihej pika, sikur ai të mos përsëritej para syve dhe veshëve tanë nga ana e atyre që pretendojnë se kanë arritur majat e kulturës dhe civilizimit dhe që na lodhin duke ngritur parullat dhe motot e rrejshme të kinse bashkëjetesës dhe ndërtimit të urave që lidhin kulturat dhe civilizimet, si dhe gjoja se i respektojnë fetë. Këto, gjithsesi, janë vetëm fjalë dhe formalitet, ndryshe ata nuk do ta ofendonin të Dërguarin tonë [alejhîs salatu ves selam], nuk do të bënin karikatura për të, nuk do të talleshin dhe nuk do ta përqeshnin atë. Natyrisht, kjo që kanë publikuar, në krahasim me atë që fshehin në zemrat e tyre, është shumë pak. Poeti thoshte:

Ditët do t'i shfaqin gjërat që nuk i dije

Dhe do t'i sjellin lajmet e tyre që fare nuk i ke vizituar

Këtë, praktikisht, e dëshmon fakti se ky mëkat (publikimi i këtyre karikaturave) u përsërit edhe në vende të tjera të Evropës. Edhe vende të tjera, si: Norvegjia, Suedia, Gjermania, Spanja, Franca dhe Anglia, nuk e kursyen veten nga ofendimi i Muhammedit [alejhîs salatu ves selam]. Madje, tërë këtë e bën kinse nën hijen e të drejtës së lirisë së të shprehurit. Kështu deklaroi kryeministri danez, me rastin e pyetjes për kërkimin e faljes publike para muslimanëve për atë gjest intolerant. Kultura dhe civilizimi i tyre bëhen dhe më të komplikuar dhe ironike kur në kushtetutat dhe ligjet e këtyre shteteve gjen sanksione për ata që fyejnë çifutët, qoftë edhe me një fjalë të vetme. 'Çdokush që shfaq ndjenja armiqësia ndaj semitëve duhet ndëshkuar.' Madje, përvetësimi i ligjeve të tilla i është kërkuar edhe OBK-së. Por këto ligje nuk i përfshijnë edhe muslimanët. Nëse fyhet Islami, Muhammedi [alejhîs salatu ves selam] dhe muslimanët, atëherë nuk parashihen sanksione. Krejt çfarë bëhet në këto raste është distancimi nga ato veprime, kinse për hir të së drejtës së të shprehurit.

Ndaluni o danezë dhe ju liderë perëndimorë! Mjaft më me broçkulla të tilla! Ku mbetën objektivizmi dhe paanshmëria juaj?! Deri kur do ta fshihni fytyrën e vërtetë para botës mbarë dhe në veçanti para muslimanëve? Ku mbeti respekti dhe kultura juaj karshi një miliardë e gjysmë muslimanëve? A harruat se ata muslimanë kanë ndjenja humane dhe fetare?! A keni harruar se ata janë ithtarë të fesë së vërtetë?! Si lejoni që ata të nënçmohen dhe ndëshkohen? Si pajtoheni të përdhosen Libri (Kur'ani) i tyre dhe të shahet Pejgamberi i tyre?! Si nuk ju vjen turp që, pas gjithë kësaj, të kërkonit prej tyre të jenë paqësorë në mënyrë që bota të jetojë në paqe dhe harmoni?!

Ju lutemi, nëse dëshironi që muslimanët t'iu lënë të qetë, atëherë më parë lërnini ju ata të qetë dhe ndalini gjuhët tuaja nga zullumi ndaj tyre!

DREJT NJË PROJEKTI TË ISLAMIZIMIT TË SHKENCAVE SHOQËRORE - VËSHTRIM KULTUROR

Allahu i Madhëruar, në Librin e Tij fisnik, thotë:

Thuaj: "Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras tek All-llahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është All-llahu, e unë nuk jam nga idhujtarët." (Jusuf, 108)

Shumë komentues të Kur'anit shprehjen 'ala besiretin' (ashtu siç e ka përkthyer edhe Sherif Ahmeti) e kanë komentuar si dituri dhe udhëzim, fakt dhe realitet, dije prej Allahut të Madhëruar.

Ummeti islam është duke përjetuar një nga fazat më të vështira të tij. Është shkapërderdhur dhe përçarë aq sa është bërë për t'u vajtuar dhe për të thurur elegji për të. Ai karakterizohet nga ngecja dhe prapambetja në ekonomi, politikë, shoqërori, shkencë, dhe kjo si pasojë e largimit të tyre nga mësimet islame. Kjo gjendje është si shpërblim për llojin e veprës. Është e vërtetë ajo që ka thënë Allahu i Lartësuar në Kur'an:

"E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kiametit do ta ringjall të verbër." (Taha, 124-125)

Çfarëdo e keqe që mund t'ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai u fal." (esh-Shura, 30)

Gjendja është kjo, por, fatbardhësisht, edhe sëmundja edhe ilaçi janë identifikuar, dhe krejt ajo që na mbetet është fillimi i terapisë, nëse duam shërim. Dijetarët dhe mendimtarët e ummetit kanë dhënë propozime të ndryshme për daljen nga kriza. Disa prej tyre, gjendjen e dobët të ummetit, ia atribuojnë dobësimin të besimit dhe, rrjedhimisht, propozojnë një përkushtim sa më të madh në këtë drejtim; të tjerë konsiderojnë se kriza është për shkak të mjegullisë dhe paqartësisë në idetë dhe programet tona, andaj edhe kërkojnë fokusim më të madh në këtë aspekt. Konsideroj - e

Allahu e di më së miri- se problemi qëndron në të dy aspektet e përmendura: në atë të besimit, ngase siç po shohim motivi fetar është dobësuar shumë, por edhe në atë ideor dhe programor, për shkak të mungesës së transparencës dhe mungesës së perceptimit të parametrave të dispozitave fetare që vlejnë për çdo kohë dhe vend.

Të nderuar mendimtarë dhe hoxhallarë!

Për rikthimin e ummetit në skenë, besoj se, pa humbur kohë fare, duhet filluar me shërimin e këtyre sëmundjeve të ummetit, duke startuar nga përmirësimi i rrjedhës ideore, ndryshimi i metodologjive edukative arsimore, përmirësimi i besimit dhe lidhjes me Allahun e Madhëruar. Tërë këtë proces, dijetarët e kohës sonë e kanë përfshirë në kuadër të një emërtimi të ri *'Islamizimi i shkencave shoqërore'* ose *'Procedura e islamizimit të shkencave'*.

Ekziston një grup intelektualësh muslimanë që pretendojnë se ka kundërthënie të mëdha ndërmjet shkencave islame dhe atyre shoqërore dhe se bashkimi i tyre është i pamundur, duke aluduar kështu se nisma e islamizimit të shkencave shoqërore është vetëm humbje kohe.

Pavarësisht këtyre bindjeve, projekti apo nisma në fjalë jo vetëm që i zhvleftëson bindjet e tyre, por edhe hap shtigje të reja për shpëtimin e ummetit. E përderisa i zhvleftëson bindjet e cekura më parë, ky projekt po kështu dëshmon se vërtet ummeti vuan ende nga problemet që ka në besim dhe në ide për qasjen ndaj problemeve të jetës. Problemi më kryesor, që duhet trajtuar në mënyrë imediate në këtë gjendje, në këtë situatë dhe në këto rrethana, mendoj se qëndron në krizën ideore dhe metodologjike. Nëse rruga e ideve dhe metodologjive ndryshon, atëherë shpresat për një të ardhme të ndritur të ummetit janë të mëdha. E nëse dështojmë këtu, atëherë vihet në pikëpyetje jo vetëm e ardhmja, por edhe e tashmja në të cilën po jetojmë.

Dosja e nismës për islamizimin e njohurive

Çfarë bart kjo dosje në brendësi të saj?

Çfarë synon të realizojë?

Cilat janë qëllimet dhe objektivat e saj?

Ç' mendime ndajnë dijetarët dhe mendimtarët muslimanë për suksesin e këtij projekti të madh shkencor?

Cila është përvoja e Universitet Islam Ndërkombëtar në Malajzi për nismën në fjalë?

Këtyre pyetjeve të shumta do të mundohemi t'ua japim përgjigjen shkurtimisht në vijim.

Së pari, për domethënien dhe kuptimin e kësaj nisme janë dhënë definicione të shumta, të cilat përputhen në mes vete në disa pika të caktuara dhe në tjera kundërshtohen.

1. Ushtrimi i aktivitetit shkencor në zbulimin, grumbullimin, transmetimin dhe publikimin e të dhënave për gjithësinë, jetën dhe njeriun nga perspektiva dhe këndvështrimi islam.
2. (Nisma, në fakt, është) Adresa e një metodologjie ideore për kulturim civilizues në dy dimensione:
 - a. I pari prej të cilëve ka të bëjë me kontributin e reflektimeve islame bashkëkohore dhe përpjekjet intensive për tretjen e tërë kapitalit perëndimor, atij kulturor material dhe tjetrit civilizues moral.
 - b. Ndërsa i dyti ka të bëjë me kujdesin për nevojën e domosdoshme të sigurimit se procedura e kodifikimit të të arriturave perëndimore, që janë zhvilluar e kultivuar nën hijen e botëkuptimeve filozofike, materialiste dhe ateiste, do të bëhet duke i rikomentuar ato dhe duke i lidhur me një kornizë standarde islame, e cila është e lidhur me udhëzimin hyjnor, përsosja dhe përmbyllja e të cilit është bërë me Islam...

3. Konsolidimi apo themelimi islam për shkencë shoqërore nënkupton procedurën e rithemelimit të shkencave shoqërore nën hijen e konceptit islam për njeriun, shoqërinë dhe ekzistencën...

Ndërsa ne mendojmë se 'Nisma për Islamizimin e Shkencave Shoqërore' nënkupton punën institucionale dhe ekipore, si dhe angazhimin metodologjik dhe objektiv, nën hijen e konceptit islam për gjithësinë, njeriun dhe jetën, në të cilin jo vetëm që do të bëhej spastrimi i shkencave nga elemente të huaja ideore, pagane, ateiste, sekulariste, komuniste etj., por njohuritë do të merrnin sfond fetar dhe alternativa islame.

Së dyti, çfarë synojmë me këtë nismë? Ne, mendimtarët dhe thirrësit islamë, duhet ta kemi të qartë se nisma apo projekti për islamizimin e shkencave është grandioz dhe me përgjegjësi të mëdha. Ai është obligim fetar që na është hedhur si barrë mbi supë për të shpëtuar ummetin nga kjo dekadencë shkencore, ekonomike, shoqërore dhe politike.

Ose më qartë, ajo që mëtojmë me realizimin e këtij projekti përmbledhet në pikat në vijim:

1. Realizimi i një aspekti themelor dhe bazik në ndërtimin e ummetit që do të merrej vetëm me idenë, perceptimin dhe substancën vlerore dhe filozofike të njeriut.
2. Ky islamizim nënkupton krijimin e një metodologjie të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirëse islame, e cila do të mbështetej në Vahj (shpalljen hyjnore), por jo në llogari apo dëm të mendjes. Kjo për arsye se Vahji është udhëzuesi i mendjes, individit dhe shoqërisë njerëzore.
3. Islamizimi, po kështu, nënkupton njohuritë që rrjedhin nga vlerat e Vahjit dhe objektivat e Shpalljes, si dhe që lidhen (bashkëveprojnë) me çdo gjë të mirë dhe të çmueshme nga korpusi i vlerave dhe trashëgimisë së ummetit, si dhe nga kontributi i mendimtarëve dhe dijetarëve të tij, përgjatë gjithë historisë.
4. Islamizimi i Shkencave Shoqërore sot renditet si prioriteti kryesor i ummetit, i cili synon të zhvillojë metodologjinë ideore dhe refleksive

islame dhe ta bëjë spastrimin e saj nga njollat që i janë ngjitur përgjatë shekujve.

5. Ky projekt ka nevojë të shoqërohet me fuqi intelektuale dhe ideore, me vizion të qartë, me ofrimin e kapaciteteve dhe pajisjeve ideore dhe vizionare, me ofrimin e kurrikulave të nevojshme ideore dhe kulturore...
6. Kjo nismë nuk bie ndesh dhe as nuk nënkupton se munda i bijve të ummetit në fusha të ndryshme duhet anashkaluar. Përkundrazi, nisma synon integrimin e përbashkët dhe plotësimin e njëra-tjetrës.
7. Nisma e Islamizimit të Shkencave, në kuptim të gjerë, bën fjalë për një kornizë të jetës së njeriut, kulturës dhe zhvillimit njerëzor.

Këto janë pikat në të cilat fokusohet procedura e islamizimit, gjatë punës së saj, dhe e kritikës konstruktive nga aspekti i metodikës, teorisë së njohurive dhe vlerave.

Ndërsa sa i përket përvojës së Universitetit Ndërkombëtar Islam të Malajzisë, si dhe suksesit të tij në aplikimin dhe ekzekutimin e kësaj nisme, do të sugjeroja që kjo nismë t'i kthehet filozofisë, motos, mesazhit dhe vizionit të këtij Universiteti, që ka bërë bashkë tradicionale dhe moderne, fenë dhe dynjanë, të publikuara në ueb-sajtin zyrtar të tij www.iiu.edu.my

Ne fund meritat dhe lavdatat i takojne Allahut xh.sh.